



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
**PREFEKTI QARKU FIER**

**RAPORT VJETOR**  
**PER VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT TË**  
**PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

**Viti 2021**

## PËRMBAJTJA

I. Raportim dhe informim në ushtrim të funksionit të Prefektit të qarkut.....	3
II. Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore.....	9
1. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore që janë depozituar në zyrën e protokollit të institucionit të Prefektit.....	9
2. Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.....	12
3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të besueshmërisë ligjore të akteve.....	12
III. Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me degët territoriale dhe institucionet shtetërore në nivel vendor.....	17
1. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.....	17
2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier.....	19
3. Drejtoria Vendore e Policisë Fier.....	19
4. Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit.....	21
5. Drejtoria e Doganës Fier.....	22
6. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.....	23
7. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Fier.....	24
8. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Fier.....	25
9. Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.....	29
10. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Fier.....	32
11. Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Jugor.....	32
12. OSHEE Drejtoria Rajonale Fier .....	34
13. Drejtoria Rajonale E Arsimit Parauniversitar, Fier.....	35
14. Agjencia Rajonale E Ekstensionit Bujqësor Lushnjë.....	37

15. Sektori i bordit të kullimit.....	40
16. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....	42
17. Drejtorja e Spitalit Rajonal Fier.....	44
18. Njësitë Vendore Të Kujdesit Shëndetësor.....	45
19. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.....	49
20. Drejtorja Rajonale E Shërbimit Social Shtetëror .....	52
21. Administrata Rajonale E Zonave Të Mbrojtura’ .....	54
22. Agjencia Rajonale E Mjedisit, Fier.....	55
V. Mbrojtja Civile në qark.....	61
VI. Task Forcat, Komitetet Rajonale si dhe Organi Këshillues pranë Prefektit të qarkut.....	66
VII. Rekomandime.....	79
VIII. Objektivat për vitin 2020.....	80

## 1. RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT

Në veprimtarinë e tij të punës një-vjeçare, institucioni i Prefektit të qarkut Fier ka funksionuar dhe ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, me aktet ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrive të linjës, në drejtim të garantimit të zbatimit të programit të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësisë gjatë vitit 2021, u fokusua jo vetëm në forcimin e rritjes së rolit të Institucionit bazuar në ligjin për Prefektin e Qarkut, por edhe në forcimin dhe bashkëpunimin real me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Territoriale, Policinë Vendore, në forcimin e menaxhimit të Situatës së pandemisë të krijuar nga Covid 19, Emergjencave Civile dhe sidomos të marrëdhënieve me Qytetarin. Viti 2021 u konsiderua si viti i funksionimit të konsolidimit të qasjes së re, të marrëdhënieve midis Institucionit të Prefektit të Qarkut në raport me Ministrinë dhe Institucionet e tjera Qendrore, me Degët Territoriale që veprojnë në qark dhe NJVQV në kushtet e situatës së krijuar për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, në dy drejtime:

- Së pari, Ligji 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i cili ka marrë në konsideratë organizimin e ri pas reformës territoriale administrative, ka përcaktuar rolin e prefektit si përfaqësues të Këshillit të Ministrave në qark, me mision për të garantuar zbatimin e programit të qeverisë në nivel qarku, duke vendosur edhe përgjegjësitë e kompetencat e tij për realizimin e këtij misioni;
- Së dyti, programi të Qeverisë 2017 – 2021 në vitin e katërt të zbatimit të tij, kërkonte një impenjim maksimal të këtij institucioni për përfundimin me sukses të reformave të nisura, në kushtet e reja të krijuara nga COVID-19, si dhe për arritjen e objektivave të vendosura.

Institucioni i Prefektit qarku Fier ka shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; ka intensifikuar punën lidhur me bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të institucioneve dhe drejtues të NJVV, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë kësaj periudhe.

Gjatë vitit 2021, institucioni i Prefektit të qarkut ka intensifikuar punën në drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Po kështu institucioni i Prefektit të qarkut ka bashkërenduar veprimtarinë dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjellët të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

Në fillim të vitit 2021, janë hartuar planet vjetore sektoriale të punës dhe janë përcaktuar objektivat e institucionit të Prefektit të qarkut.

Në muajin janar të vitit 2021 është hartuar dhe miratuar plani vjetor i punës së institucionit të Prefektit të qarkut si dhe janë përcaktuar prioritetet dhe objektivat e sektorëve dhe të gjithsecilit për realizimin me sukses të gjithë veprimtarisë së institucionit.

Gjatë vitit 2021, me prioritet të veçantë janë trajtuar dhe ndjekur të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të adresuara pranë Prefektit të qarkut. Problematikat dhe shqetësimet e qytetarëve kanë pasur të bëjnë me shërbime të ndryshme dhe detyrime për organet e vetëqeverisjes vendore dhe një numër i konsiderueshëm i tyre për institucionet rajonale vendore.

Një nga shërbimet që institucioni i Prefektit ofron për qytetarët është legalizimi i dokumenteve të lëshuara për përdorim jashtë vendit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në total përgjatë vitit 2021 numri i legalizimeve ka qenë **43 941** copë.

Gjatë vitit 2021, në Protokollin e institucionit të Prefektit janë përpunuar në total 1561 shkresa, dhe protokolluar gjithsej 54 urdhëra të Prefektit

Një vëmendje e veçantë iu është kushtuar ankesave të qytetarëve, të cilat i janë adresuar për zgjidhje njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Nga të gjitha ankesat e trajtuara, të cilat lidhen me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo vendimmarrjen e këshillave bashkiakë, vihet re se një pjesë e mirë e tyre kanë marrë zgjidhjen ligjore, por kërkohet një angazhim më i madh nga ana jonë për rritjen e shërbimit ndaj komunitetit dhe dhënien e zgjidhjes përfundimtare të problematikave të tyre.

, Prefekti ka realizuar takime me kryetarët e Bashkive ku u diskutua mbi realizimin e projektit mbi adresat e qytetarëve . Po kështu pas takimeve të Kryeministrit lidhur me aksionin e pastrimit të territorit dhe të problematikave me ujësjellësit, prefekti ka realizuar takime me nënkryetarët e Bashkive, Drejtorët e Ujësjellësve në Bashkitë e qarkut Fier. .

Prefekti i qarkut organizoi takim me nënkryetarët e bashkive edhe mbi bashkëpunimin mes institucionit të Prefektit të qarkut dhe njëjësive të vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Në fund të muajit nëntor, fillim dhjetori të vitit 2021, Qarku Fier u përball me fatkeqësinë natyrore, të përmbytjeve, kryesisht nga Lumi Vjosë, në Bashkinë Fier. Pati veç dëme materiale . Prefekti i qarkut i ka kërkuar NJVQV rivlerësimin e situatës dhe marrjen e masave për të përballuar situata të tilla. Gjatë kësaj periudhe, në mënyrë sistematike nga ana jonë është raportuar çdo javë dhe çdo muaj pranë Zyrës Operacionale të Situatës në Kryeministri, Drejtorisë së Çështjeve Vendore dhe Funksioneve të Deleguara pranë Ministrisë së Brendshme si dhe në ministritë e tjera të linjës për veprimtarinë, problematikat dhe realizimet e detyrave në rang qarku të institucionit të Prefektit të qarkut.

Në zbatim të planit të auditimit për vitin 2021, miratuar nga Ministri i brendshëm me nr. 335 datë 19.10.2019, bazuar në ligjin 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në sektorin publik” gjatë kësaj periudhe është kryer auditimi i veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier,01.07.2019-31.03.2021. Auditimi kishte si qëllim vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, përputhshmërinë e


veprimtarisë me aktet ligjore e nënligjore, vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit, evidentimin e mangësive dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen.

Me urdhërin nr 43.datë 24.09.2020 të Prefektit të qarkut Fier u miratua “Zbatimi i Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Prefektit të qarkut si dhe Aneksi Për Procedurat e verifikimit dhe Kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, sipas urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 175 datë 09.07.2020 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme, Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”

Përsa i përket realizmit të buxhetit për vitin 2021, prej institucionit të Prefektit të qarkut Fier është synuar zbatimi i ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe respektimit të parimeve të ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit të shpenzimeve.

**Buxheti total i planifikuar për vitin 2021 është 35089 mijë lekë**

- Të ndara sipas programeve:
  - Administrata e Prefektit, 32524 mijë lekë.
  - Gjendja civile, si funksion i deleguar 2565 mijë lekë.
- Të ndara sipas llojit të shpenzimeve:
  - Paga, shpërblime, të tjera shpenzime personeli 23336 mijë lekë (67 %)
  - Kontributi i sigurimeve shoqërore 4543 mijë lekë (13 %)
  - Mallra & shërbime të tjera (shpenzime operative) 6534 mijë lekë (18 %)
  - Transferta tek individët 676 mijë lekë (2 %)
  - Shpenzime për investime nuk kemi pasur për vitin 2021.
  - Në mënyre grafike, pesha specifike e zërave të buxhetit ndaj totalit, paraqitet si më poshtë:



#### 5.1 Realizimi i buxhetit.


Realizimi i shpenzimeve, paraqitet në mënyrë të detajuar sipas tabelës së poshtëshënuar:

**në 000 lekë**

ARTIKULLI	STRUKTURA BUXHETORE	BUXHETI	REALIZIMI	DIFERENCA	REALIZIMI NË%
600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	23336	21943	1393	94 %
601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësorë	4543	3556	987	78.27%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	6534	5562	972	85 %
606	Transferta tek individët	676	602	74	89 %
	<b>TOTALI</b>	<b>35089</b>	<b>31663</b>	<b>3426</b>	<b>90.23%</b>

Në mënyrë grafike, realizimi i shpenzimeve faktike, ndaj planit buxhetor, paraqitet si më poshtë:

## REALIZIMI BUXHETIT 2021



Në total buxheti është realizuar në masën 90.2%

- Shpenzimet për paga, shpërblime, shpenzime personeli, janë realizuar 94 %
- Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 78 %
- Mallra dhe shërbime të tjera, 85 %
- Transferta tek individët, 89%

Përsa i përket realizimit të fondit të pagave në masën 94% vjen si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante.

Shpenzimet për Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, janë realizuar në masën 78 %, që vjen si rezultat i mosrealizimit të fondit të pagave dhe për arsye të mosplotësimit të vendeve vakante.

Përsa i përket realizimit 85 %, në artikullin 602 mallra dhe shërbime, me diferencë në vlerë absolute me 972 mijë lekë, vlen të theksojmë se kjo ka ardhur si rezultat i kursimeve dhe mirë administrimit, të shërbimeve, si ujë, energji, shpenzime postare, shërbime telefonike etj, mosrealizimit të shpenzimeve për pritje përcjellje për shkak të pandemisë dhe i diferencës së fondeve të prokuruarra për blerjet e vogla me ato të kontraktuara.

Përsa i përket investimeve, nuk kemi pasur fonde të akorduara për shkak të pamundësisë së akordimit, si rezultat i pandemisë. Konsolidimi i imazhit të institucionit nëpërmjet rritjes së kontrollit të brendshëm financiar dhe menaxhimit të risqeve nëpërmjet përdorimit me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet të burimeve financiare, hartimi i një plani të detajuar të burimeve financiare nëpërmjet transparencës sipas klasifikimit buxhetor, studimin e hollësishëm të nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde, për vitin 2021, duke bashkëpunuar me gjithë sektorët, respektimin e parimit të transparencës, ligjshmërisë, shmangien e shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.



Gjatë vitit 2021, aktiviteti financiar i Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, ka ushtruar veprimtarinë e tij, në zbatim të Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008, “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10296, date 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar , Ligjit Nr. 9131 date 09.09.2003 “Për rregullat e etikes në Administratën Publike”, si dhe te gjitha aktet ligjore e nënligjore ne fuqi.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, në ushtrimin e aktivitetit institucional, ka synuar realizimin e objektivave të vitit 2021, duke përdorur me efektivitet fondet buxhetore, në shërbim të rritjes së imazhit të institucionit. Ky objektivi është realizuar më mirë në menaxhimin e burimeve financiare, duke bërë të mundur përdorimin e tyre me efektivitet, ekonomi, dhe efikasitet. Për vitin 2021 është realizuar prokurimi, “Për mirëmbajtje të Objekteve ndërtimore për riparim të dy tualeteve në katin e dytë”, riparimi i sallës së mbledhjeve dhe pajisja e tyre me perde është një tjetër investim për vitin e kaluar me qëllim përmirësimin e kushteve të punës për nëpunësit. Gjithashtu, janë realizuar punime në ambientet e katit të parë, po për krijimin e kushteve të punës dhe higjienës, riparim dhe lysterje e disa zyrave ekzistuese, janë prokuruar fondet për bazë materiale si kancelari, detergjente etj.

Arkiva, në zbatim të planit vjetor ka punuar për eliminimin e prapambetjes arkivore të pa dorëzuar në arkivën qendrore, ka punuar mirë dhe janë gati 2 vite për dorëzim, të cilat duhet të dorëzohen sipas një plani të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Theksojmë se janë disa vite të cilët duhet të ishin dorëzuar në Arkivën Qendrore në respektim të afateve ligjore. Situata me dorëzimin e materialit të prapambetur të viteve 1999-2000-2001 në arkivë, të cilat ishin planifikuar te dorëzoheshin deri në fund të vitit 2021 është si më poshtë vijon: Njëpërmjet shkresës me nr. 7680/1 Prot, datë 06.07.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, protokolluar në institucionin tonë me nr. 721 prot. datë 08.07.2021 konfirmohet marrja në dorëzim nga DPA-ja e dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare të vitit 1999 me fondkrijues Prefektin e Qarkut Fier. Njëpërmjet shkresës me nr. 1269 prot. datë 18.10.2021 të Prefektit të Qarkut Fier, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave është bërë kërkesa nga ana jonë për dorëzim dokumentesh RHK për vitin 2000 dhe 2001. Njëpërmjet shkresës me nr. 11947/1 prot. datë 25.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1269/1 prot. datë 26.10.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka njoftuar ardhjen e Inspektorit Rajonal për verifikimin e procesit të përpunimit. Ndër të tjera në shkresë, si risi, nënvizohet se për dokumentet e viteve 2000 dhe 2001, kusht për marrjen në dorëzim të tyre ishte hedhja e draftit të inventarit në sistemin elektronik të DPA-së, katalogu.arkiva.gov.al si dhe kutitë bashkë me dosjet e dorëzimit duhet të ishin të standardit të përhershëm dhe jo më të atij normal në të cilat dokumentet ishin përpunuar më parë. Njëpërmjet shkresës me nr. 11947/2 prot. datë 12.11.2021, protokolluar me tonën me nr. 1269/2 prot. datë 15.11.2021, janë komunikuar nga DPA-ja rregullimet e nevojshme që duheshin bërë për dokumentet RHK të vitit 2000, brenda datës 03.12.2021. Inspektori u paraqit në datën e sipërpërmendur dhe vërtetoi kryerjen e rregullimeve për dokumentet RHK të vitit 2000 brenda afatit, gjë e cila vërtetohet me mungesën e gjobës për specialistin e Arkiv-Protokollit. Pritet caktimi i datës nga inspektori Rajonal për dorëzimin e dokumenteve në Arkivin Shtetëror Lushnjë.

## II. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Marrëdhëniet midis Prefektit të qarkut dhe njërive të vetëqeverisjes vendore përcaktohen në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e qarkut” dhe në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njërive të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie. Marrëdhëniet ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njërive të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

### 1. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të njërive të vetëqeverisjes vendore që janë depozituar në zyrën e protokollit të institucionit të Prefektit

Në zbatim të kompetencave që i jep ligji 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, Prefekti i qarkut Fier edhe gjatë vitit 2021 ka realizuar procesin e verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative të organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore duke zbatuar procedurën e parashikuar në nenin 16 të ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut”. Për të gjitha vendimet e depozituara pranë zyrës së protokollit të institucionit të Prefektit është bërë verifikimi dhe është formuluar shkresa përcjellëse me pasqyrimin e argumentimit ligjor për konfirmimin ose jo të këtyre akteve brenda afateve ligjore.

Për vitin 2021 nga gjashtë njësi të vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë dhe një njësi e vetëqeverisjes vendore e nivelit të dytë Këshilli i Qarkut Fier, në Institutin e Prefektit të Qarkut janë depozituar dhe shqyrtuar për vlefshmëri ligjore 116 vendime me karakter normativ të organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore. Janë verifikuar në përputhje me ligjin 99 vendime të këshillave. Janë kthyer jo në përputhje me ligjin 16 vendime, ndërsa për 1 vendim të këshillit bashkiak Patos është kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë. Gjatë vitit 2021 janë verifikuar në vend 90 vendime me karakter normativ.

Vendimet e kthyer jo në përputhje me ligjin kanë pasur si shkak kryesisht mosnjohjen e ligjit apo mos kompetencën e këshillit bashkiak, mos bërjen e dëgjësave publike. Gjatë vitit 2021 nuk ka patur vendime të dërguara në gjykatë për pavlefshmëri.

Vendimet me karakter normativ kanë qenë me natyrë kryesisht financiare si miratimi i buxheteve, paketës fiskale, PBA-së, ndryshime të buxhetit, paktës fiskale, rishpërndarje fondesh në buxhet, miratimi i shtesave të fondit të buxhet, miratimi programeve sociale, rregulloreve të ndryshme, miratimi i kriterëve apo standardeve që lidhen me funksionet që i kanë kaluar këshillit ndryshime të planit të përgjithshëm vendor etj. Krahasimisht me vitin 2020 vihet re një numër më i vogël aktesh të paraqitura nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, por gjithashtu edhe një përqindje më e madhe e akteve të kthyer të pakonfirmuara.

Konkretisht në vitin 2021 nga totali i akteve të paraqitura për konfirmim nuk janë konfirmuar 0.13% e akteve, ndërsa në vitin 2020 nuk kanë marrë konfirmimin e Prefektit 0.04% e akteve të paraqitura.

**Pasqyra e akteve normative të NJVQV-ve për vitin 2021 është si më poshtë:**

Nr.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të organeve të qeverisjes vendore									Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve		Dërguar në gjykatë		Vendime të pa konfirmuara, në proces për kërkim informacioni	
	Njësiti e qeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara ne ligj		Të rishqyrtuara nga OQV							
		Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog	Mujore	Prog
1	Këshilli i Qarkut Fier	0	5	0	5	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
2	Bashkia Fier	0	24	0	20	0	4	0	0	0	19	0	0	0	0
3	Bashkia Patos	0	18	0	14	0	3	0	0	0	16	0	0	0	1
4	Bashkia Roskovec	0	30	0	25	0	5	0	0	0	25	0	0	0	0
5	Bashkia Mallakastër	0	17	0	16	0	1	0	0	0	12	0	0	0	0
6	Bashkia Lushnje	0	12	0	9	0	3	0	0	0	9	0	0	0	0
7	Bashkia Divjakë	0	10	0	10	0	0	0	0	0	7	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>		0	116	0	99	0	16	0	0	0	90	0	0	0	1

Për të gjitha vendimet e depozituara nga NJVQV-të është bërë verifikimi ligjor i thelluar dhe sipas rastit nga sektori juridik është formuluar shkresa përcjellëse me pasqyrimin e argumentimit ligjor për konfirmimin ose jo të këtyre akteve brenda afateve ligjore.


Nga evidenca e akteve rezulton se:

Bashkia me numërin më të madh të akteve normative të depozituara për verifikim ligjor është bashkia Roskovec, me 30 vendime ndërsa Këshilli i Qarkut Fier rezulton me numrin më të vogël, 5 vendime.

NJVQV-të me numrin më të vogël të vendimeve të kthyera janë Këshilli i Qarkut Fier dhe Bashkia Divjakë me asnjë vendim të kthyer.

Kurse njësitë e tjera janë si më poshtë:

- Bashkia Mallakastër me 1 vendim.
- Bashkia Lushnje me 3 vendime.
- Bashkia Patos 3 vendime.
- Bashkia Fier me 4 vendime.
- Bashkia Roskovec 5 vendime.



Në çdo rast të kthimit të akteve të njësitë të vetëqeverisjes vendore, nga ana jonë është bërë argumentimi ligjor i papajtueshmërive të konstatuara. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me sekretarët e

këshillave të bashkive por edhe me specialistët sipas kërkesave në funksion të përmirësimit të punës në lidhje me vendimet e këshillave bashkiakë dhe besueshmërisë së tyre ligjore.

Nga ana e Institucionit është bashkëpunuar me sekretarët e këshillave, drejtoritë juridike në bashkitë e Qarkut Fier për evidentimin e saktë të akteve me karakter normativ të cilat duhet të depozitohen nga këto të fundit për verifikim ligjor.

Standardizimi i dokumentacionit dhe i procedurave nga NJVQV-të në vendimmarrje ka qenë një sfidë edhe për vitin 2021 e cila ka dhënë edhe rezultatet e saj pozitive. Është punuar shumë në drejtim të dokumentacionit që shoqëron vendimet konkretisht në fillim të verifikimit ligjor, është kontrolluar dokumentacioni standard që shoqëron vendimin projektvendim relacion dhe dëgjuesë publike kur kërkohet nga ligji. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar faktit që dokumentacioni shoqërues të këtë të gjithë elementet formal që kërkohen nga ligji për arkivat dhe rregullorja e brendshme e këshillit bashkiak. Krahasuar me një vit më parë standardizimi i dokumentacionit nga NJVQV-të ka një ndryshim pozitiv të ndjeshëm që duhet evidentuar. Gjatë vitit 2021 ka më pak vendime të kthyera për plotësim dokumentacioni.

## **2. Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore**

Në zbatim të nenit 17 të Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 50, datë 12.04.2017, “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, si dhe Urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr. 175, datë 9.7.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të qarkut” si dhe aneksin 1, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut është kryer verifikimi në vend i akteve me karakter normativ në mënyrë efektive dhe periodike çdo tre muaj duke garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi për sa i përket verifikimit ligjor të akteve.

Janë verifikuar gjithsej 90 akte me karakter normativ. Kontrolli është përqendruar në veprimtarinë e vendimmarrjes së këshillave bashkiakë/këshillave të Qarkut dhe në verifikimin e akteve me karakter normativ të vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave të organit ekzekutiv, Kryetarit të Bashkisë. Gjatë verifikimit në vend të akteve me karakter normativ në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Qarkun Fier është analizuar dokumentacioni që ndodhej në arkivë për mbledhjet e këshillave bashkiak/këshillit të Qarkut Fier si dhe janë verifikuar aktet e miratuara nga kryetari i bashkisë.

-Dokumentacioni i kërkuar për verifikim ka qenë :

*-Rregullore e funksionimit të këshillit të bashkisë/këshillit të qarkut.*

*-Aktet e këshillit të bashkisë/këshillit të qarkut për periudhën objekt kontrolli*

*-Aktet e Kryetarit të Bashkisë për periudhën objekt kontrolli*

*-Libri i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak/këshillit të Qarkut për vitin 2021.*

Nga verifikimi në vend në të gjitha kontrollet periodike që janë kryer në NJVQV-të ka rezultuar se nuk ka akte normative të pa depozituara për verifikim ligjor të *Këshillit të Bashkisë/Këshillit të Qarkut si dhe nuk ka akte me karakter normativ të Kryetarit të Bashkisë të pa depozituar për verifikim ligjor.*

Gjatë kontrolleve në vend janë evidentuar edhe mangësi të ndryshme në dokumentacionin e këshillave të listuara si më poshtë:

### **Mangësitë e konstatuara në Këshillin e Qarkut Fier**

Nga ana e Këshillit të Qarkut Fier nuk është miratuar procesverbali i mbledhjes në përputhje me Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 16.

Gjatë kontrollit të fundit të verifikimit në vend në muajin dhjetor rezulton se nga ana e Këshillit të Qarkut Fier është përmbushur ky rekomandimi i lënë.

#### **• Mangësitë e konstatuara në Bashkinë Fier**

- Për njoftimin e rendit të ditës në disa raste nuk është respektuar afati i parashikuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 53 pika 4 në të cilën parashikohet se njoftimi për mbledhjen bëhet jo më pak se 5 ditë përpara mbledhjes.
- Në disa raste nuk është respektuar afati i përgatitjes së materialeve të mbledhjeve, projekt-vendim, relacion të cilat duhet tu vihen në dispozicion këshilltarëve së bashku me rendin e ditës jo më pak se 5 ditë përpara.
- Procesverbali i mbledhjes nuk mbahet në një libër të sekretuar, të vulosur dhe protokolluar por një bllok shënimesh i cili nuk përmban asnjë element të parashikuar nga Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe nga Rregullorja e Këshillit Bashkiak Fier Nr.27 datë 15.04.2020 neni 81 pika 7.
- Procesverbali i mbledhjes nuk mbahet nga sekretari i këshillit bashkiak por nga një punonjëse tjetër gjë që është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 16 dhe Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Bashkisë Fier miratuar me vendim Nr. 27 datë 15.04.2020 neni 81 pika 1 përgjegjësi e sekretarit të këshillit.
- Projekt vendimet janë të pa numërtuara.
- Procesverbali i mbledhjes paraardhëse nuk është i miratuar siç kërkohet në Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” neni 16 dhe rregulloren e këshillit, përgjegjësi e sekretarit të këshillit, kryetarit të këshillit dhe kryesisë së këshillit.
- Nuk është kryer procedura e këshillimit publik për vendimin me karakter normativ Nr. 58 datë 06.08.2021 i Këshillit të Bashkisë Fier “Për miratimin e rregullores të Muzeut Historik Fier”

përgjegjësi e sekretarit të këshillit, komisionit përkatës të këshillit, kryesisë së këshillit dhe kryetarit të këshillit.

- Tek rendi i ditës është parashikuar edhe një pikë ku thuhet “*të ndryshme*”. Vendosja e një pike të tillë është e paligjshme. Hartimi i rendit paraprak të ditës është parashikuar në Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Bashkisë Fier miratuar me vendim Nr. 27 datë 15.04.2020 neni 62. Rendi i ditës duhet të jetë i qartë dhe transparent. Në fillim të mbledhjes, rendi i ditës miratohet nga këshilli bashkiak. Për shtesa apo heqje nga rendi i ditës vendos këshilli me vendim. Ekzekutivi është i detyruar të respektojë afatet e hartimit të projekt-vendimeve dhe relacioneve. Modeli i formatit të njoftimit të rendit të ditës është miratuar dhe është pjesë e rregullores së këshillit bashkiak, njoftimi duhet të hartohet sipas këtij formati

Sqarojmë se gjatë kontrollit të fundit të verifikimit në vend në muajin dhjetor kemi konstatuar një reflektim nga ana e bashkisë Fier ku rezulton se :

- Të gjitha mangësitë e mësipërme janë rregulluar me përjashtim se ende mund të konstatohet ndonjë rast që ekzekutivi i Bashkisë Fier nuk ka përgatitur materialet për mbledhje në afat, ndërsa numërtimi i projektvendimeve me numër progresiv siç na kanë vënë në dijeni do të filloj të aplikohet nga mbledhja e parë e muajit janar 2022.

#### **Mangësitë e konstatuara në Bashkinë Lushnjë**

Në dy raste është konstatuar se Këshilli Bashkiak Lushnje nuk ka kryer konsultimin publik në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” (i ndryshuar) neni 18 dhe Ligjit Nr. 146/2014 “*Për njoftimin dhe konsultimin publik*” si dhe në zbatim të vendimit të këshillit Nr. 36 datë 24.04.2020 “*Për miratimin e rregullores së marrëdhënieve të këshillit bashkiak me publikun, median, konsultimet*”.

Vendimet të cilat janë miratuar pa u zhvilluar procedura e konsultimit publik nga ana e këshillit bashkiak Lushnje, janë kthyer në kundërshtim me ligjin.

#### **Mangësitë e konstatuara në Bashkinë Mallakastër**

Te rendi i ditës është parashikuar edhe një pikë ku thuhet “*të ndryshme*”. Vendosja e një pike të tillë është e paligjshme. Hartimi i rendit paraprak të ditës është parashikuar në “Rregulloren për funksionimin e këshillit të Bashkisë Mallakastër” miratuar me Vendim KB Mallakastër Nr.12 datë 24.02.2020 neni 55.

Te rendi i ditës nuk parashikohet miratimi i rendit të ditës, dhe i procesverbalit të mbledhjes paraardhëse. Procesverbali i mbledhjes paraardhëse nuk është i miratuar siç kërkohet në Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*” neni 16.

Procesverbali i mbledhjes nuk mbahet në një libër të sekretuar, të vulosur dhe protokolluar por fletë formati A4 duke mos pasur elementet e parashikuar nga Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike

të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe nga Rregullorja e Këshillit Bashkiak Mallakastër Nr.12 datë 2.04.2020 neni 73 pika5.

Gjatë kontrollit të fundit të verifikimit në vend në muajin dhjetor kemi konstatuar se nga ana e bashkisë Mallakastër janë përmbushur të gjitha rekomandimet

#### **Mangësitë e konstatuara në Bashkinë Divjakë**

Te rendi i ditës është parashikuar edhe një pikë ku thuhet "*të ndryshme*". Vendosja pike të tillë është e paligjshme. Hartimi i rendit paraprak të ditës duhet të bëhet në përputhje me neni 62 të rregullores për funksionimin e këshillit të Bashkisë Divjakë të miratuar me Vendim KB Divjakë Nr. 34 datë 09.06.2020.

Te rendi i ditës nuk parashikohet miratimi i rendit të ditës dhe i procesverbalit të mbledhjes paraardhëse. Procesverbali i mbledhjes paraardhëse nuk është i miratuar siç kërkohet në Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*" neni 16 dhe rregulloren e këshillit.

Projektvendimet janë të numëtuara por jo me numër progresiv. Në çdo mbledhje projektvendimet fillojnë me numrin 1.

Gjatë kontrollit të fundit të verifikimit në vend në muajin dhjetor bashkia Divjakë ka përmbushur rekomandimet e lëna me përjashtim të numërtimit të projektvendimeve me numër progresiv gjë e cila do të filloj në mbledhjen e parë të këshillit në muajin janar.

#### **Mangësitë e konstatuara në Bashkinë Patos**

Në disa raste nuk është respektuar afati i përgatitjes së materialeve të mbledhjeve, projekt-vendim, relacion të cilat duhet tu vihen në dispozicion këshilltarëve së bashku me rendin e ditës jo më pak se 5 ditë përpara.

Procesverbali i mbledhjes nuk mbahet nga sekretari i këshillit bashkiak por nga një punonjës tjetër gjë që është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*" neni 16 dhe Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillit të bashkisë Patos miratuar me vendim Nr. 18 datë 22.04.2020 neni 83 pika 1.

Te rendi i ditës është parashikuar edhe një pikë ku thuhet "*të ndryshme*". Vendosja e një pike të tillë është e paligjshme. Hartimi i rendit paraprak të ditës duhet të bëhet në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillit të Bashkisë Patos të miratuar me Vendim KB Patos Nr. 18 datë 22.04.2020 neni 65.

Te rendi i ditës nuk parashikohet miratimi i rendit të ditës dhe i procesverbalit të mbledhjes paraardhëse përgjegjësi e kryetarit të këshillit dhe kryesisë së këshillit për hartimin paraprak të rendit të ditës.

Gjatë kontrollit të fundit të verifikimit në vend në muajin dhjetor rezulton se bashkia Patos i ka përmbushur rekomandimet e lëna nga grupi i kontrollit me përjashtim të mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes, që ende nuk mbahet nga sekretari i këshillit bashkiak Patos por nga një punonjës i bashkisë, edhe pse i është tërhequr vëmendja në mënyrë të vazhdueshme gjatë verifikimit ligjor të akteve.



### **Mangësitë e konstatuara në Bashkinë Roskovec**

Është konstatuar 1(një) rast që tek rendi i ditës për mbledhjen e datës 30.06.2021 nuk është parashikuar miratimi i procesverbalit të mbledhjes paraardhëse gjë që është në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Roskovec të miratuar me vendim Nr. 19 datë 27.03.2020 neni 67.

Libri i mbajtjes së procesverbaleve të mbledhjeve por nuk ishte i protokolluar.

Projekt vendimet nuk janë të numërtuara me numër progresiv.

Gjatë kontrollit të fundit të verifikimit në vend në muajin dhjetor rezultoi se bashkia Roskovec i ka përmbushur të gjitha rekomandimet e lëna nga grupi i kontrollit.

Në përfundim të verifikimit në vend është hartuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore raporti përfundimtar duke lënë edhe rekomandimet përkatëse.

### **3. Zhvillimi i takimeve konsultative me kryetarët dhe sekretarët e këshillave bashkiak si dhe dërgimi i shkresave orientuese për mangësitë e konstatuara gjatë verifikimit ligjor të akteve me karakter normativ.**

Një vëmendje e veçante i është kushtuar anës formale të dokumentacionit që i bashkëlidhet akteve me karakter normativ, konkretisht procesverbalit të mbledhjeve, projekt vendimit dhe relacionit. Për këtë qëllim iu është dërguar bashkive shkresa e datës 05.07.2021 “Mbi sjelljen në vëmendje të plotësisimit të elementëve të anës formale të akteve normative dhe dokumenteve shoqëruese të tyre”

Nga ana e NJVQV-ve ka patur reflektim, gjithsesi komunikimi me sekretarët ka qenë i vazhdueshëm dhe rast pas rasti, me qëllim konsultimin në drejtim të përmirësimit të punës dhe rritjes së cilësisë së akteve të tyre si nga pikëpamja e përmbajtjes dhe besueshmërisë së tyre në ligj ashtu edhe nga ana formale.

Në këtë kuadër në ambientet e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier është zhvilluar takimi konsultues në datën 16.09.2021 me kryetarët e këshillave, sekretarët e këshillave bashkiakë me objekt :

- ✓ Konsultimi publik
- ✓ Dokumentacioni që shoqëron vendimmarrjen
- ✓ Problematika të konstatuara gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve.

U përgatit një material i hollësishëm lidhur me kërkesat ligjore për konsultimin publik të akteve i detyrueshëm për tu kryer nga NJVQV-të, procedurat që duhet të ndiqen nga këshillat bashkiak në rastin e një akti për të cilin kërkohet konsultim publik ku në fokus ishin vendimmarrjet për buxhetin bashkiak dhe paketën fiskale. Gjithashtu sqarime të hollësishme u dhanë lidhur me dokumentacionin standard që shoqëron aktet me karakter normativ që depozitohen për verifikim ligjor tek Prefekti i Qarkut për procesverbalin e mbledhjes, projektvendimin, relacionin në ballafaqim me kërkesat ligjore që kërkojnë

“Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” si dhe rregullorja e brendshme e funksionimit të këshillit bashkiak.

Pjesë e takimit ishin edhe evidentimi i një sërë problematikash të konstatuara gjatë verifikimit ligjor të akteve me karakter normativ dhe verifikimit ligjor në vend, korrigjimin e tyre në vendimmarrjet në vazhdim.

-Gjatë zgjedhjeve qendrore të mbajtura më 25 prill 2021 Prefekti I Qarkut ka hartuar korrespondencën me bashkitë e qarkut Fier për me vendin e numërimit të votave (VNV) konkretisht për vendndodhjen, sipërfaqen e VNV-së si dhe kriteret teknike që plotëson VNV-ja. Gjithë informacioni së bashku me planimetritë i është dërguar brenda afatit KQZ.

-Si përfaqësues të Institucionit, P/Sektorit Juridik së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm ka marrë pjesë në mbledhjen konsultative që është zhvilluar në ambientet e Bashkisë Lushnje me pjesëmarrjen e këshillit bashkiak Lushnje, ekzekutivit të bashkisë si dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme lidhur me procedurat ligjore për caktimin e kryetarit të bashkisë nga këshilli bashkiak për shkak të avancës së krijuar nga shkarkimi të kryetarit aktual Z. Fatos Tushe me VKM. Nga ana jonë është dhënë konsulencë se si mund të vazhdonin me procedurat referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak Lushnje i Kryetarit të Bashkisë Lushnje Znj. Eriselda Sefa për ushtrimin e funksioneve të kryetarit të bashkisë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, Institucioni I Prefektit, pas dorëzimit nga ana e saj të formularit të dekriminalizimit i është drejtuar për verifikimin e të dhënave Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje. Nga përgjigjet e kthyer rezultoi se ky subjekt nuk është në proces gjyqësor si dhe nuk ka ndryshuar të dhënat e përbërësve të gjendjes civile.

### **III. MARRËDHËNIET E PREFEKIT TË QARKUT ME DEGËT TERRITORIALE DHE INSTITUCIONET SHTETËRORE NË NIVEL VENDOR**

#### **A. Ne varësi të Kryeministrisë janë këto institucione:**

1. Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara
2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës

#### **1. AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)**

Qendra e integruar me një ndalesë në Fier, nisi funksionimin e saj për qytetarët në dt.12.05.2017 Në ADISA Fier ofrohen shërbime publike në sportele nga 7 institucione të niveleve qendrore dhe vendore. Ofrimi i Shërbimeve publike realizohet nga sportelet e institucioneve që janë nën administrimin e Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve të Integruara si dhe nga sportelet e institucioneve të tjera me të cilat ADISA ka nënshkruar marrëveshje për ofrimin e shërbimeve publike përkatëse në sportel në ambientet e qendrës së integruar.

Mënyra e organizimit dhe zhvillimit të punës realizohet në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit.

Në Janar të vitit 2020 çdo aplikim për marrjen e shërbimeve, çdo qytetar aplikon online në **e-albania** për shërbimin e kërkuar. Çdo qytetar që paraqitet në ADISA për një shërbim të caktuar suportohet për tu regjistruar në e-albania, për aplikimin si dhe për aksesimin e shërbimit të kërkuar.

### **Të gjitha shërbimet në ADISA ofrohen online nëpërmjet portalit [e-albania.al](http://e-albania.al)**

Përkatësisht nën administrimin e ADISA Fier janë sportelet e institucioneve, si:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier (ASHK, 51 shërbime)
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH, 67 shërbime)
- Fondi i Sigurimeve të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH 1 shërbim)
- Info Point (ankesa, informacion, protokoll )
- Shërbimet online që ofrohen në **e-Albania** për institucionet QKB, DPT
- Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi
- Ndihma juridike falas për kategori të ndryshme të shoqërisë

### **Arritjet e ADISA Fier.**

- a) Bashkëveprim pozitiv dhe rritje e efikasitetit në marrjen e shërbimeve në përditshmërinë për bizneset dhe qytetarët.
- b) Ndërveprim profesional dhe shërbime publike eficientë për qytetarët.
- c) Opinioni dhe zëri i qytetarëve është prioritet i shërbimeve në qendër.
- d) Trajtimi me shpejtësi dhe efikasitet i rasteve në përputhje me nevojave të qytetarëve.
- e) Informacion dhe orientim i nevojshëm për anën procedurale dhe dokumentacionin e çdo shërbimi që qytetarët shprehin interes.
- f) Edukimi i marrjes së shërbimit online në portalin **E-Albania**.
- g) Ofrimi i mundësisë për të kryer ankesa në portalin [e-shqiperiaqeduam.al](http://e-shqiperiaqeduam.al) në rastet e vonësës apo mos marrjes së shërbimit të kërkuar si dhe në rastet e mos respektimit të të drejtave të qytetarëve.
- h) Trajtimi dinjitoz dhe dhënia e shërbimit cilësor për qytetarët.
- i) Rritja profesionale e punonjësve që ofrojnë shërbime publike në sportelet ADISA.

## **2. AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS, FIER, LUSHNJË, MALLAKASTËR**

### **Puna e Drejtorisë vendore, Fier për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:**

Numri i objekteve me dokumentacion teknik të përfunduar dhe vendim për legalizim (planimetri, genplan) për vitin 2021; janë 922 objekte

Numri i lejeve të legalizimit të regjistruara për vitin 2021; 2841 leje legalizimi

Numri i objekteve të para me funksion banim, të ndërtuar në tokë të vetë deklaruesit ;143 objekte

Certifikata të lëshuara për tokën bujqësore (AMTP e reja + të vjetrat) : 823 AMTP dhe TOTAL 1800 Certifikata.

**Puna e Drejtorisë vendore Lushnje për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:**

Nr. i Certifikatave të lëshuar duke përfshirë dhe transaksionet në Bashkinë Lushnje dhe Divjake është 1596

Vendim për legalizim duke përfshirë Bashkinë Lushnje dhe Divjakë:312 vendime legalizimi

Vërtetim Pronësie duke përfshirë Bashkinë Lushnje dhe Divjakë :1981 vërtetime pronësie

Nr. i AMTP-ve të trajtuara duke përfshirë Bashkinë Lushnje dhe Bashkinë Divjakë: 878 AMTP

**Puna e Drejtorisë vendore Mallakastër për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:**

Leje legalizimi të ardhura nga Drejtoria Vendore Fier për këtë periudhë janë:50 leje legalizimi

Nga periudha paraardhëse në total janë:352 leje.

Ne bashkëpunim me Drejtorinë Vendore Fier janë punuar 147 leje.

Janë njoftuar qytetaret për të bërë pagesat dhe të pajisen me Certifikatë Pronësie.

Pa punuar janë : 68 kërkesa

Ne proces pune janë:137 leje, janë prere elementet dhe janë njoftuar qytetaret, për të aplikuar që të pajisen me certifikatë.

Janë punuar Leje dhe janë prodhuar Certifikata në total 59 (copë certifikata).

Qytetaret janë njoftuar në mënyrë të përsëritur nga zyra por interesi ka qenë i ulët për të bërë pagesat edhe tërheqjen e certifikatave.

A.M.T.P janë punuar 72 dosje, dhe janë prodhuar 248 certifikata për token bujqësore.

Për këtë periudhë janë kryer 1700 aplikime, shërbimin e kanë marrë brenda afatëve.

Janë protokolluar 1052 shkresa, janë kthyer përgjigje Prokurorive, Komisariateve të Policisë, Drejtorive vendore të Policive, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, etj.

Të gjitha aplikimet për shërbime po kryhen sipas udhëzimit të fundit nëpërmjet e-Albania.

**B. Në varësi të Ministrisë së Brendshme janë këto institucione**

1. Drejtoria Vendore e Policisë
2. Drejtoria Rajonale për kufirin dhe Migracionin
3. Inspektorati Kombëtar për mbrojtjen e Territorit

**3. DREJTORIA VENDORE E POLICISË**

- Drejtoria Vendore e Policisë Fier për periudhën Janar-Dhjetor 2021, e orientoi punën e saj bazuar mbi Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021- 2026, dhe aktet normative ligjore që normojnë punën e Policisë së Shtetit.
- **Prioritetet e këtij institucioni :**
- Studimi dhe njohja e dinamikës së kriminalitetit në shkallë qarku

- Rendi dhe Siguria Publike, Siguria Rrugore dhe partneriteti me Komunitetin
- Rikonceptimi i shërbimeve të Qarkullimit Rrugor, me objektiva dhe parametrat e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Rrugore dhe në përputhje me kushtet konkrete të qarkut tonë
- Krimet Kundër Mjedisit, Mbrojtja e Regjimit Juridik të Tokës, si ndërtimet pa leje dhe gjithë gama e krimeve mjedisore,
- Lufta kundër paligjshmërisë, në territorin që mbulon DVP Fier, dhe Komisariatet e Policisë

### **Përmbledhje e kriminalitetit për vitin 2021.**

#### **Për Janar-Dhjetor të vitit 2021**

- janë evidentuar **2369** vepra penale,
- zbuluar **2246**, ose **94.8 %**,
- janë implikuar **2573** persona, nga të cilët, janë arrestuar **773**, ndaluar **123**,
- janë ndjekur në gjendje të lirë **1576** dhe janë shpallur në kërkim **101**.
- **Puna e bërë për parandalimin e Kultivimit të bimëve narkotike.**

#### **Gjatë vitit 2021**

- Në juridiksionin e Qarkut Fier janë evidentuar **50** raste të kultivimit të bimëve narkotike,
- zbuluar **38**, me zbulueshmëri **76%**,
- janë implikuar **58** persona nga të cilët **31** janë arrestuar, **8** janë ndaluar, **9** janë ndjekur në gjendje të lirë, **10** janë shpallur në kërkim.

#### **Nga sektori i Qarkullimit Rrugor**

- janë evidentuar **461** vepra penale
- zbuluar **448**, me zbulueshmëri **97.1 %**,
- janë implikuar **460** persona, nga të cilët,
- janë arrestuar **238**,
- ndaluar **5**,
- janë ndjekur në gjendje të lire **206** dhe për **11** është bërë shpallja në kërkim.

<b>Viti 2021</b>		
<b>Aksidente Rrugore 25</b>		
Vdekur	Plagosur rëndë	Plagosur lehtë

28	43	83
----	----	----

#### **Drejtimet kryesore të punës së forcave të policisë së rendit**

##### **Garantimi i rendit dhe sigurisë para, gjatë dhe pas sezonit turistik veror 2021, mbarëvajtja e gjithë aktiviteteve kulturore sportive në Qarkun Fier**

Për sezonin turistik-veror 2021 DVP Fier është angazhuar maksimalisht me forcat dhe mjete për mbarëvajtjen e tij duke përballuar flukse të konsiderueshme pushuesish si vendas dhe te huaj dhe ajo që vlen të përmendet dhe vlerësohet maksimalisht është se gjatë gjithë sezonit turistik nuk ka patur asnjë incident apo vepër penale të ndodhur në zonën e plazhit Divjakë-Seman-Darëzezë-Pishporo- Levan.

##### **Siguria në Institucionet Arsimore publike dhe jo publike.**

Situata e rendit dhe qetësisë publike në Institucionet Arsimore ka qenë në nivele të kënaqshme. Është bërë e mundur siguri i shërbimeve të rendit dhe sigurisë rrugore në çdo shkollë si edhe është bashkëpunuar ngushtë me oficeret e sigurisë në shkolla, drejtoritë e shkollave, stafet pedagogjike, komunitetin e nxënësve dhe atë të prindërve.

**Bashkëpunimi Institucional me Organet e Qeverisjes Vendore dhe Institucionet e tjera ligjzbatuese** dhe në veçanti me IKMT, për kontrollin e territorit lidhur me ndërtimet e paligjshme dhe krimet mjedisore sidomos në zonat bregdetare, turistike dhe ato brenda vijës së verdhë.

**Zbatimin korrekt të Akteve Normative** që kanë të bëjnë me parandalimin e përhapjes së Infeksionit Covid-19.

#### **4. INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT**

**IKMT**, Drejtoria Rajonale Fier është një institucion i ri i krijuar në varësi të Ministrisë Brendshme. Për vitin 2021. Institucioni ka punuar në bazë të urdhërave të ardhur nga qendra në zbatim të ligjit të IKMT-së. Janë akoma në fazë ristrukturimi në pritje të plotësimit të akteve nënligjore për funksionimin normal të IKMT-së.

Për periudhën Janar 2021 deri në datë 21.05.2021 IKMT Drejtoria Rajonale Fier ka funksionuar në zbatim të urdhërave me Nr. 2015 datë 26.10.2020 mbi krijimin e grupeve të punës mbi sistemin, përshkrimin dhe përpunimin e dokumenteve të arkivës së Drejtorive Rajonale të IKMT-së dhe urdhëri Nr.30, datë 15.02.2021 për shtyrjen dhe zbatimin e urdhrit të sipërpërmendur deri më datën 28.05.2021.

Për periudhën 24.05.2021 deri më datën 31.12.2021, ka funksionuar në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr.465, datë 21.05.2021, Për Krijimin e Taskforcës Vendore në Nivel Qarku ,për marrjen e masave për mbrojtjen kontrollin dhe monitorimin e territorit, mjedisit dhe pyjeve nga ndërhyrjet, ndërtimet e kundërligjshme.

**IKMT** Drejtoria Rajonale Fier i ka realizuar objektivat dhe:

- ka zbatuar të gjitha urdhërat që kanë ardhur nga IKMT qendër,
- planet mujore të punës të hartuara bashkërisht me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, bazuar urdhrin të Taskforcës Vendore,
- ka kryer raportimet periodike javore dhe mujore për realizimin e punës së kryer pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe IKMT qendër.

**C. Në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë**

1. Dega e Doganës
2. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit
3. Drejtorinë Rajonale e Formimit Profesional Publik
4. Drejtorinë Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave
5. Institutin e Sigurimeve Shoqërore
6. Drejtoria Rajonale Tatimore

**5. DEGA E DOGANËS FIER**

Objektivi kryesor i degës doganore është mbledhja e të ardhurave doganore si dhe shërbimi sa më profesional i punonjësve ndaj bizneseve dhe individëve.

Mision i rëndësishëm është ai mbrojtjes, që ka të bëjë me mbrojtjen e shëndetit publik, mbrojtjen e sigurisë kombëtare, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e shëndetit publik.

- Analiza e të Ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2021

Gjatë 12 muajve mbledhja e të ardhurave është realizuar në shumën 2,813525, mijë/lekë ose e shprehur në % në masën 118% të totalit, planifikuar.

- Për 12- mujorin 2021 janë planifikuar të ardhura për arkëtim në masën 2,390220 mijë/lekë dhe është realizuar nga mbledhja e të ardhurave vlera në shumën 2,813525 mijë/lekë ose e shprehur në % në masën 118%
- Në strukturë krahasimi plan/fakt realizohet si më poshtë:

Taksa doganore është realizuar në masën 114%

Akciza është realizuar në masën 140%

Tvsh-ja është realizuar në masën 112% e cila zë shifrën më vlerë absolute më të madhe.

Renta Minerare është realizuar 340.28%, por edhe si tregues në vlerë absolute relativisht e ulët.

**Problematika të ndryshme**

- ✓ Plotësimi i strukturës organike me qëllim realizimin e detyrave
- Ka në strukturë 43 punonjës dhe aktualisht dhjetor 2021 ka 34 punonjës.

- ✓ Trajnimi i personelit me qëllim rritjen cilësore dhe profesionale në kryerjen më me kompetencë të detyrave që lindin në sektorin e mbikëqyrjes doganore


## 6. DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT FIER

Veprimtaria e DRSHKP Fier për vitin 2021 është e përqendruar në rritjen e cilësisë së shërbimeve të punësimit ndaj dy kategorive të klientëve si punëkërkuës ashtu edhe punëdhënës si edhe në rritjen e shkallës së bashkëpunimit me institucione dhe organizma të tjerë që kryejnë veprimtarinë e tyre në rrethin Fier dhe kanë si objektiv të tyre uljen e nivelit të papunësisë dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik.

### 1.Situata e papunësisë së regjistruar.


Numri i punëkërkuësve të papunëve të regjistruar pranë Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit Fier është 5990 pu pa :

#### ➤ Fieri 2672 pupa



Numri i punëkërkuësve të papunëve femra të regjistruara është 3364 .

- Fieri 1548 pupa
- Lushnja 2397 pu pa





- Grupmoshat mbi 40 vjeç zënë 60.3% të papunëve të regjistruar. Nga bizneset kërkohen moshën nën 40 vjeç.
- Pjesa më e madhe e të papunëve janë me arsim 9-vjeçar. Këta drejtohen drejt arsimit profesional për të marr një profesion dhe më pas për tu integruar në tregun e punës

**Mbështeten me të ardhura 1277 (374,587,316) pupa ose 21.3 % e pupa të regjistruar.**

Të ndarë sipas skemave të trajtimit janë:

- përfitojnë pagesë papunësie 230 (143 Fieri, 80 Lushnja, 7 Mallakstra) pupa
- përfitojnë ndihmë ekonomike 1047( 231,507,309) pupa

### **Realizimi i treguesve të monitorueshëm për vitin 2021:**

- Janë realizuar 2067 punësime nga 2645 punësime që ishte objektivi ose 78%.

Të ndara sipas kategorive kemi:

- Punësime nga punëdhënësi 1290 pu pa.
- Pjesëmarrës në programet e nxitjes së punësimit 258pu pa ose 184%.

Prej totalit të punësimeve.

- Janë punësuar nga ndihma ekonomike 61 pupa .
- Janë punësuar nga grupet rome & egjiptian 13 pupa .
- Pjesëmarrës në formim profesional janë 529 pu pa.

### **Problematikat e hasura**

- ✓ Mosgjetja e kandidatit të përshtatshëm për vendin e punës.
- ✓ Të regjistruarit në DRAKPA janë në pjesën më të madhe pa profesione, gjithashtu nuk e kanë një gjuhë të huaj, e cila mund të jetë kusht për vendin e punës.
- ✓ Të rinjtë që kanë mbaruar arsimin e lartë nuk pranojnë të punojnë jashtë profilit.
- ✓ Mosplotësimi i vendeve të punës në profesionet (mekanik, elektroaut e punonjës të tjerë të makinerive) pasi nuk përputhet moshën me eksperiencën e punës që kërkohet.
- ✓ Refuzimi ivendit të lirë për arsye të largësisë nga vendi i banimit.

## **7. DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER**

**Misioni i Drejtorisë Rajonale të Ofritit të Formimit Profesional Publik** është materializimi dhe zbatimi në praktikë i politikave të punësimit të Shtetit Shqiptar me qëllim krijimin e kushteve për aftësim profesional veçanërisht të shtresave në nevojë, duke zgjidhur drejtë moton se : "Rruga drejt punësimit kalon nëpërmjet formimit profesional"

Kurset e hapur që zhvillohen në disa prej Bashkive që mbulon DRFPP Fier:

1. Berber
2. Modelim veshjesh për femra
3. Instalim dhe mirëmbajtje kondicionerësh
4. Saldim

5. Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik
6. Mobilieri
7. Rrobaqepësi
8. Kuzhinë
9. Qëndistari
10. Estetikë
11. Servis elektroaut në automjetet e lehta
12. Servis xhenerik në automjetet e lehta
13. Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike
14. Manikyr-pedikyr
15. Punime pllaka shtrimi
16. Riparime elektroshtëpiake
17. Parukeri
18. Kujdestar fëmijësh
19. Sipërmarrje dhe zhvillim i planit të biznesit

#### Të dhëna statistikore në total për vitin 2021

- Të trajnuar gjithsej gjatë gjithë periudhës Janar–Dhjetor 2021: 650 kursantë
- Punëkërkues të papunë të trajnuar gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021:

442 kursantë

#### 8. DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Të ardhurat në total si DRSSH për vitin 2021 u realizuan në masën **101 %** ose nga 387, 000 mijë lekë të planifikuara u realizuan 391, 974 mijë lekë, realizuar me shume 4,974 mijë lekë.

#### Realizimi i te ardhurave ne total dhe me zëra

000/leke

Totali			Bujku privat			Vullnetari			Te ardhura te tjera		
Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
387,000	391,974	101	350,000	353,331	101	37,000	38,608	104	-	35	

#### Sipas subjekteve:

a). Të ardhurat nga **sigurimi vullnetar** u realizuan në masën **104 %**, ose nga 37,000 mijë lekë te planifikuara u realizuan 38,608 mije leke duke realizuar me tepër 1,608 mije leke .Gjate

vitet 2021 u siguruan ne skemën e sigurimit vullnetar 282 persona , nga te cilët 139 ishin kontribuues te rinj për here te pare ne skeme.

**b).** Të ardhurat nga **të vetëpunësuarit në bujqësi** janë realizuar në masën **101 %**, ose nga 350,000 mijë lekë të planifikuara u realizuan 353,331 mijë lekë duke realizuar me tepër 3,331 mijë lekë. Gjate vitit 2021 u siguruan ne skemën e te vetepunesuarve ne bujqësi 4,761 persona , nga te cilët 1,081 ishin kontribues te rinj për here te pare ne këtë skeme.

## II PERFITIMET AFATGJATA DHE AFATSHKURTRA

- **Përfitimet afatgjata**

-

Aktualisht DRSSH Fier menaxhon **84,299 pensione aktive ne fund te vitit 2021.**Jane lidhur gjithsej **6,731 pensione te reja gjate vitit 2021.**Pensione te reja dhe aktive

LLOJI	Viti 2021	
	te reja	aktive
pleqëri	4,578	66,051
invalid	211	6,087
familjar	315	4,603
sociale	19	296
suplementare	1,608	7,263
<b>TOTALI</b>	<b>6,731</b>	<b>84,299</b>

-Rritje kanë patur pensionet e pleqërisë, pensionet suplementare si dhe pensionet për shkak të ligjit 29/2019 dt 23.05.2019 “Për trajtimin financiar ,suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera nëntoke ,të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit dhe punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

-Në DRSSH Fier gjatë vitit 2021 janë pritur gjithsej 6,185 kërkesa për pension pleqërie, familjar, invalid dhe 30 aplikime për pension social.

-Janë shqyrtuar dhe caktuar ne afat 98 % te pensioneve te pleqërisë, 99 % pensionet familjare, 100 % pensionet sociale. Kane qene arsye objektive qe kane sjelle pensione te caktuara jashtë afatit, këto ne një numër me te vogël krahasuar me një vit me pare.

**-Ditët mesatare te caktimit te një pensioni ne total janë 25 ditë.**

-Në DRSSH Fier janë trajtuar gjithsej 1,608 kërkesa ne skemën suplementare.

### Realizimi i përfitimeve afatshkurta

RAJONI	TOTALI				
	Numri i rasteve		Dite paaftësie	Shpenzimet (000/leke)	Nr. mesatar mujor raste te paguara
	gjithsej	te reja	gjithsej		
Paaftësi e përkohshme nga sëmundjet e përgjithshme	494	454	23,341	27,758	82
Paaftësi e përkohshme nga aksidentet ne pune	7	5	298	555	1
Raporte barre lindjesh	2,077	1,231	357,345	210,138	1,170

### Objektivat

- Vazhdimi i punës për implementimin efektiv të skemës së reformuar të sigurimeve shoqërore (pensionet dhe përfitimet e tjera nga skema e sigurimit të detyrueshëm, pensioni social, pensioni i pleqërisë për punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë dhe ne profesione te tjera te vështira)
- Rritja e cilësisë, aplikimi online, plotësimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve , shkurtimi i afateve së shërbimit ndaj qytetarëve dhe përmirësimi i performancës së stafit të pranimit dhe përpunimit të përfitimeve me synim marrjen e vendimeve te bazuara ligjërisht, ne përputhje me dokumentacionin e saktë e të verifikuar, uljen e afatit të lidhjes së pensioneve.
- Zbatimi i programit elektronik te aplikimeve në të gjitha Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore dhe Qendrave ADISA për pranimin, llogaritjen dhe caktimin e pensioneve.

- Zbatimi i sistemit te aplikimit, administrimit dhe pagimit online te përfitimeve te degës së sigurimit për sëmundje, barre lindje, aksidente dhe sëmundje profesionale dhe pagesave të vdekjeve.
  - Zbatimi i programit te Sistemit te Qarkullimit Elektronik te Dokumenteve (SQDNE) me institucionet, me qellim shkurtimin e kohës dhe aksesit për te nxjerre DRSSH-ja çdo dokument pa ia kërkuar qytetarit plotësimin e dosjes me dokumentacion.
  - Mirëmenaxhimi i skemave suplementare, trajtimeve të veçanta dhe financimeve te tjera në administrim të ISSH-se, me qëllim ruajtjen e fondeve të Buxhetit të Shtetit .
- **Shpenzime për përfitime** janë realizuar në masën 102.1% ose me një tejkalim prej 280,570,mijë lekë.

Rritja e shpenzimeve për barre lindje ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të lindjeve dhe rritja e shpenzime për pagesa vdekje vjen si rezultat i rritjes së numrit të vdekjeve, për shkak të situatës së vështirë të shkaktuar nga Covid 19.Persa i përket tejkalimeve te pensioneve te pleqërisë dhe familjare ,rritja vjen si rezultat i rritjes se fluksit te emigranteve ,pas një periudhe te gjate kohe ,dhe tërheqja e pensioneve me më shume se 1 muaj deri ne tre vite .

**Shpenzimet për programet e tjera janë** realizuar ne masën 138.4 % ,ose 365,268 mije lekë me shume .Ne këtë grup tejkalim ka vetëm zëri “Kompensim për te ardhurat e pensionisteve me 112.7 % ose 412,617 ne mije leke ne qytet dhe 1.3 % ose 971 mije ne fshat ,që vjen si rezultat i marrjes se shpërbllimit te fundvitit . **Shpenzimet për skema suplementare ne total** janë realizuar 89.1% ose 83,548 mijë lekë me pak

### **Shpenzimeve administrative**

Shpenzimet administrative janë realizuar në masën 98,2 % ose 1,831 mijë lekë më pak se plani.

-Gjatë vitit 2021 në total janë përpunuar rreth **5,200 kërkesa** (përfshirë Alssh Fier, Lushnje dhe Mallakastër) nga të cilat janë kthyer përgjigje 100%.

-Kërkesa online nga qytetaret për vitin 2021 kemi patur 500 kërkesa , nga te cilat janë kthyer përgjigje 100%.

-Afati i kërkesave online është 10 ditë

-Kërkesat e paraqitura në arkivë kryesisht vijnë prej institucioneve të ndryshme si: Drejtoria e Policisë, Prokuroria dhe Gjykata, kërkesa të avokatëve etj, kthimi i përgjigjeve të cilave realizohet brenda një kohe 7-10 ditë pune. Gjatë vitit 2021 kërkesa të kësaj natyre kanë ardhur në Arkivën e Drssh Fier rreth 620 kërkesa.

-Dega e Arkivës ka tërhequr dokumentacionin e ndërmarrjeve të Bashkisë Fier në masën 95%.

Prej datës 01.01.2020 shumica e shërbimeve të DRSSH Fier, filluan të ofroheshin vetëm **online përmes portalit e-albania**.

Gjatë **vitit 2021** ky proces ka ecur me ritme të shpejta, duke numëruar në **total 21,240 kërkesa** për shërbime të ndryshme online të ardhura nga ADISA.


Duke filluar nga nëntori i vitit 2020 është bërë unifikimi i hedhjes së pagesave të vdekjeve online në sistemin informatik .

## 9. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, FIER

Misioni i Drejtorisë Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Në Janar-Dhjetor 2021 janë regjistruar 1116 subjekte dhe janë çregjistruar 751 të tillë.

### Të ardhurat



### Arsyetime lidhur me Plan-Fakt-in Janar – Dhjetor 2021

- Plani i të ardhurave për periudhën Janar- Dhjetor është realizuar në masën 105% ose 7,590,983 milion lekë në neto dhe 104% ose 8,609,319 milion lekë në bruto.

- Tatim fitimi është realizuar 3 % më shumë se plani, Tap është realizuar 14 % më shumë se plani dhe sigurimet 7 % më shumë se plani.


**Mos realizim është : Tvsh bruto 88 % e planit dhe taksat 71 % e planit.**

<b>FDP Totale</b>	<b>Janar - Nentor 21</b>
<b>Shitjet total</b>	78,057,577,860
<b>Shitjet me tvsh</b>	52,362,115,555
<b>Blerjet me tvsh</b>	56,669,919,106
<b>Teprica</b>	-2,700,547,135
<b>Detyrim</b>	2,525,729,274

Performanca e TVSH së deklaruar sipas indikatorëve 11 mujori



**DEKLARIMI TVSH 2021**




**Gjatë vitit 2021 :**

- **Shitjet e përjashtuara janë rritur me 39 %**
- **Shitjet pa TVSh janë rritur me 45 %**
- **Exportet e mallrave janë rritur me 12 %**
- **Shitjet e tatueshme janë rritur me 10 %**
- **Shitjet e tatueshme 6 % janë rritur me 57 %**
- **Furnizimet me shkalle 0 % janë rritur me 118 %**
- **Importet e mallrave janë rritur me 18 %**
- **Importet e investimeve janë rritur me 25 %**
- **Tvsh-ja e detyrueshme për tu paguar është rritur me 10 %**
- **Blerje te përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH janë rritur me 36 %**
- **Blerje investimi Brenda vendit pa tvsh janë rritur me 139 %**
- **Tvsh e detyrueshme për tu paguar është rritur me 10 %**

**Ecuria e shitjeve paraqitet në tabelën më poshtë:**





#### **D. Ne varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**

1. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Fier.
2. Autoriteti Rrugor Shqiptar, Gjirokastër.
3. OSHEE, Drejtoria Rajonale Fier.

#### **10. DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, FIER**

Kriteret e ushtrimit të veprimtarisë për shërbimet që ofrohen në Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor bazohen mbi politikat e zhvillimit të fushës së veprimtarisë të orientuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor gjate vitit 2021, ka bërë një punë relativisht të mirë në të gjitha degët për arritjen e treguesve ekonomiko-financiar të planifikuar sipas Projekt Programit Ekonomiko-Financiar miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Disa të dhëna për vitin 2021 të shprehura në numër veprimesh:

- Numri në total i veprimeve për 2021: 251 002 veprime.
- Regjistrimi I mjeteve : 80 564 veprime
- Drejtuesit e mjeteve + kualifikime profesionale: 56 025 veprime
- Taksat: 74 765 veprime

- Kontrolli teknik + të tjera veprime: 39 738 veprime

## **11. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, GJIROKASTËR**

Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë është një Drejtori që varet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar

Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë ka në juridiksionin e saj 5 Qarqe të Jugut të Shqipërisë:

Qarku Gjirokastrë, Fier, Vlore, Berat dhe Korçë. Kjo Drejtori ka si aktivitet kryesor ndjekjen, monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve.

Banka Botërore lidhi kontrata afatgjata 5 vjeçare me kompanitë fituese të procedurave të prokurimit të realizuara nga vete Banka Botërore. Gjithashtu ajo ka strukturat e saj për monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtyre kontratave që janë Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Bankës Botërore pranë A.Rr.Sh. Tirane dhe një Kompani Mbikëqyrëse të Kontratave “IRD Engineer” me qendër në Tiranë dhe përfaqësues të saj për çdo Kontratë.

Konkretisht për Qarkun e Fierit segmentet rrugore sipas Kontratave janë :

Akset rrugore:

- Kufi Rrogozhinë – Fier
- Lushnje – Kufi Berat

Këto segmente janë pjesë e Kontratës “C” me Sipërmarrës “2T” shpk,

Akset rrugore :

- Fier – Kufi Vlore
- Levan – Kufi Tepelene

Këto segmente rrugore janë pjesë e Kontratës “D” me sipërmarrës “Salillari”, sh.p.k

Aktualisht për Qarkun e Fierit akset që janë të mbuluara me kontrata mirëmbajtjeje janë :

- Aksi rrugor K/Cerme – Divjake Plazh
- Jeta e Re – Kosovë
- Fier – Seman Plazh + rruga K/Pojan – Apoloni
- K/Patos – Kufi Berat
- K/Patos – Ballsh– Fratar

- Ballsh – Aranitas
- Kr/Rruga Nacionale – Bylis
- Metohasim - Kafaraj .

Gjate vitit 2022 janë planifikuar punime përmirësuese ne elementet funksionale te rrugëve si dhe ne drejtim te sigurisë rrugore.

Ne lidhje me projektet ne rrugët ne inventar te Drejtorisë sonë janë realizuar ose janë ne vazhdim disa objekte nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit siç janë:

- 1.Rikonstrukcion rruga K/Cerme – Divjake.
- 2.Rikonstrukcion rruga Roskovec – Poshnje.
- 3.Rikonstrukcion rruga Topoje – Gryke. Etj

janë mbyllur pasqyrat financiare për vitin 2021 dhe është kryer inventarizimi për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra si dhe materialet e konsumit. janë ne proces zbatimi detyrat e lenë nga KLSH dhe auditimi i ministrisë për vitin 2017. Është ne proces regjistrimi i terreneve dhe objekteve te paregjistruara ne regjistrat e ZRPP.

## 12. OSHEE DREJTORIA RAJONALE

**Misioni: Përbushja e kërkesave të konsumatorëve për furnizim të pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike nëpërmjet një shërbimi efikas dhe modern.**

Ushtron aktivitetin e saj në Rajonin Jug-Perëndim, me varësi direkte nga Drejtoria e Tensionit të Lartë Tiranë/ Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) .Mbulon me aktivitetin e saj n/st dhe linja 35kV në prefekturat Gjirokastër, Vlorë dhe Fier. Në Fier përkatësisht me bashkitë: Fier, Roskovec, Patos, Mallakastër, Lushnjë dhe Divjakë.

**Objektivi:** Qëllimi dhe detyra e OSSH është të sigurojë furnizimin me energji elektrike me cilësi dhe pa ndërprerje tek konsumatorët.

- Puna OSSH konsiston në :
- Ndjekje dhe raportim defektesh
- Parandalimin dhe eliminimin e avarive në N/st dhe linjat 35 kV  
Bashkërendim të punës me operatorët e N/st për të pasur një rendiment sa më të lartë në shfrytëzimin e pajisjeve dhe eliminimin e avarive .
- Realizimin e humbjeve të energjisë elektrike brenda kufijve të caktuar
- Realizimin me cilësi të remonteve sipas grafikut të miratuar për pajisjet e N/st dhe linjave
- Zbatimit me korrektësi të rregullores së sigurimit teknik gjatë punimeve .

Gjatë vitit 2021 janë kryer 61 remonte në linja nga 63 të planifikuara, realizimi në % është 97 %  
Gjatë vitit 2021 janë kryer 173 remonte në n/st nga 177 të planifikuara, realizimi në % është 98 %  
Gjatë vitit 2021 si rezultat i kushteve të motit dhe amortizimit të pajisjeve kanë patur 33 defekte në linja dhe 106 defekte në n/st Në të gjitha rastet e ndodhjes së avarive brigadat e eliminimit të tyre kanë qenë në gatishmëri të plotë duke bërë të mundur lokalizimin ,izolim dhe eliminimin e avarive në një kohë shumë të shkurtër .

Në të gjitha rastet e ndodhjes së avarive brigadat e eliminimit të tyre kanë qenë në gatishmëri të plotë.

Disa nga problematikat që çojnë në kohëzgjatje të defekteve janë:

- gjendja teknike e makinave,
- terreni dhe koha e papërshtatshme për ndërhyrjet,
- lloji i defektit(tokë, izolator i shpuar)
- probleme me çelësat e vjetër që kanë bllokime mekanike apo operatorë që nuk mësojnë dhe që nuk bëjnë detyrën.

Gjatë vitit 2021 janë kryer investime në n/st dhe në linja me qëllim përmirësimin e gjendjes në to, rritjen e shkallës së sigurisë dhe garantimin e furnizimit me energji pa ndërprerje. Njëkohësisht janë kryer investime në pajisjet primare të disa n/st.

Falë këtyre investimeve dhe remonteve cilësore të kryera nga grupet e mirëmbajtjes është bërë e mundur që të përballohen me sukses nevojat për energji të konsumatorëve dhe njëkohësisht të ulet ndjeshëm numri i stakimeve.

**Humbjet:** Humbjet në % në vitin 2021 :

- Plani **2.54**
- Realizimi **1.83**

**Siguria në punë :** Gjatë vitit 2021 nuk ka patur aksidente në punë të punonjësve as përmbytje e as djegie të N/st

**Logjistika, Problematikat:**

- Problematikë mbetet fakti që këto automjete, krahas riparimeve që u bëhen në servis, vazhdojnë të shfaqin po përsëri defekte për shkak edhe të amortizimit të tyre gjë e cila sjell vonesa edhe në kryerjen e punëve të Njesisë.
- Problematikë tjetër mbetet edhe mungesa e librave në n/stacione.
- Problematikë është edhe dërgimi për skrap i materialeve apo aseteve të dala jashtë përdorimit dhe që janë hedhur nëpër n/st ose grumbullimi i tyre në magazinë rikupero .
- Problematikë tjetër mbetet edhe mungesa e furnizimit me ujë të n/st të NJTL Jug- Perëndim.
- Problematika e fundit është mungesa e magazinës, pasi ajo që ishte në përdorim nga ne u privatizua nga ministria.

**Problematikat e Burimeve Njerëzore:**

- Njësia TL Jug -Perëndim Fier ka në përbërje të saj 276 punonjës dhe administron 53 n/st në shtrirje gjeografike Jug-Perëndim. Problematika kryesore e burimeve njerëzore është mungesa e personelit si atij operativ edhe atij inxhinierik.
- Problem është edhe niveli i ulët i pagave të Inxhinierëve dhe shefave të degëve .

**E. Në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

1. Drejtoria Rajonale Arsimore, Fier

**13. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER**

Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar, Fier ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit para universitar në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit para universitar me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrën që të përballojë sfidat e së ardhmes.

DRAP, Fier ka në varësi të saj :

- ✓ ZVA, FIER
- ✓ ZVA, LUSHNJE
- ✓ ZVA , MALLAKASTËR
- ✓ ZVA, DIVJAKË
- ✓ ZVA, PATOS
- ✓ ZVA, ROSKOVEC

Gjatë vitit 2021 DRAP Fier ka realizuar :

- Rritjen e nivelit të drejtimit të institucioneve arsimore dhe fuqizimin e burimeve njerëzore në institucionet e vartësisë.
- Mbështetjen fuqimisht DPAP-së dhe ASCAP për zbatimin e strategjive dhe politikave reformuese në sistemin e arsimit para universitar.
- Realizimin e zhvillimit profesional të mësuesve nëpërmjet bashkëpunimit mes tyre dhe aktorëve të specializuar.
- Inspektimin e procesit të punësimit të mësuesve sipas portalit.
- Ndjekjen e procedurave për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të IA.
- Verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë.
- Verifikimin e regjistrimeve të nxënësve në ZVAP dhe institucionet arsimore para universitare publike dhe private
- Ndjekjen e zbatimit të kurrikulës së re.
- Monitorimin e procesit të shpërndarjes së teksteve shkollore në ZVAP-të dhe institucionet arsimore publike.
- Monitorimin e procesit të provimeve kombëtare në arsimin bazë, sesioni i parë dhe i dytë, dhe vlerësimin e arritjeve në arsimin fillor.

- Vlerësimin e procesit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

*Procedura e aplikimit dhe pranimit të kandidatëve për profesionin e rregulluar të mësuesit ka ndryshuar gjatë vitit 2021, ky proces u realizua nëpërmjet portalit online*

- Vlerësimin e procedurave të Kartës së Performancës së shkollave në ZVAP-të e vartësisë.

*DRAP ka grumbulluar tabelat e renditjes së kartës së performancës së shkollave për të gjitha ZVAP-et e vartësisë, ndërsa procedura e hartimit të kartës ishte në proces ndryshimi në nivel kombëtar (u mbështet në draftin e udhëzimit të ri për KPSH-në).*

- Analizimin e gjetjeve nga inspektimet dhe monitorimet, të cilat do të shoqërohen me rekomandime për përmirësim të punës në institucionet arsimore
- Trajtimin e ankesat të mundshme dhe çështjet e dërguara nga portali i bashkëqeverisjes.

#### **Problematikat e hasura**

- *DRAP Fier ka ndjekur rregullisht procedurën në 100% të rasteve, por për shkak të mosplotësimit të kriterëve nga kandidatët **nuk është finalizuar emërimi i drejtuesve***

#### **F. Në varësi të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe administrimit të Ujërave**

1. Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Lushnjë
2. Sektori i Bordit të Kullimit
3. Autoritetin Kombëtar i Ushqimit

### **14. AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR LUSHNJË**

#### **❖ Për vitin 2021 AREB, Lushnjë ka patur objektivat si më poshtë:**

- Krijimi i lidhjeve dhe vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me aktorët e ndryshëm që veprojnë në bujqësi për të siguruar informacion të ndërsjellët.
- Organizimi i takimeve, kontakteve me partnerët e identifikuar, krijimi i lidhjeve dhe rrjetit të bashkëpunimit.
- Sigurimi, menaxhimi dhe publikimi informacionit tekniko–shkencor, ekonomik dhe tregut
- Menaxhimi i fermës
- Rritja e efektivitetit në realizimin e skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë
- Rritja e prodhimit të ullirit
- Rritja e prodhimit në pemët frutore

- Rritja e prodhimit në vreshta
- Rritja e efektivitetit në realizimin e skemave kombëtare mbështetëse të prodhimit bujqësor
- Rritja e prodhimit në kulturat perimore
- Marketingu bujqësor
- Rritja dhe intensifikimi i prodhimit blegtoral
- Zhvillimi i agroturizmit
- Promovimi i prodhimeve tipike lokale
- Mbrojtja e tokës bujqësore
- Rritja dhe intensifikimi i prodhimit foragjer

❖ **Realizimi i objektivave për periudhën Janar – Dhjetor 2021 në SEB – Fier.**

- ✓ Nga ekstensionistët e SEB Fier në funksion të realizimit të Planit Vjetor të Ekstensionit janë zhvilluar 356 takime në grupe dhe demonstrime praktike me fermerë që kanë pasur si objektiva: *krasitjet reformuese dhe shërbimet në ullishtat e vjetra , të dëmtuara nga zjarri, tuberkulozi, etj., trajtimet dimërore në pemëtari, teknikat e mulçerimit plastik në perime, për zjarrin bakterial në pemët frutore, masat e kontrollit dhe teknikat e kultivimit të vreshtave në ambiente të mbrojtura, njohjen dhe informimin e fermerëve për masat e financimit, kriteret për aplikim në skemat mbështetëse kombëtare të vitit 2021 informimin e fermerëve, për kripëzimi i tokës në sera dhe masat për eliminimin e fenomenit, prodhimet për eksport, përmirësimi i strukturës, cilësitë dhe standardeve, (Global GAP)., përgjithësimi i përvojave pozitive të fermave të asistuar nga ekstensionit gjatë vitit 2020, teknikat e mbarështimit të gjedhit për qumësht, njohuri për resurset e zonës dhe zhvillimin e agroturizmit, tenja e ullirit dhe masat e kontrollit, identifikimi dhe promovimi i prodhimeve tipike lokale bujqësore dhe blegtorale, masat për sistemimin, punimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni, minjtë e arave dhe masat e kontrollit, teknologjia e kultivimit të grurit”, “mënyrat dhe teknikat e vjeljes së ullirit sipas kultivarëve, krasitja formuese dhe prodhuese në drufrutore, trajtimet dimërore në drufrutore., etj. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë 3290 fermerë të kontaktit në rrethet Fier, Lushnje dhe Mallakastër.*
- ✓ Janë zhvilluar nga specialistët e ekstensionit gjithsej 288 tema të trajnimit me fermerë me 2842 pjesëmarrës, në 357 fshatra me një tematikë që përfshin të gjithë problematikën e evidentuar nga kontaktet me fermerët në zonat që mbulojnë për aktivitetet bujqësore, blegtorale, agropërpunimin, agroturizmin, zhvillimin rural, kooperimin, bujqësinë organike, buxhetin e fermës, etj.

- ✓ Janë realizuar 570 vizita në fermë për të vrojtuar planifikimin në fermë, diagnostikimi i saj me ndihmën e të ardhurave bruto, ku të qartësohet efekti i përfitimit nga përdorimi me efikasitet i faktorëve të tillë si baza materiale, aplikimi i teknologjive, shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve prodhuese të tokës e blegtorisë, ndryshime në strukturën e mbjelljeve dhe kafshëve që mbarështon, përfshirja në procesin e marketingut, etj.
- ✓ Për përdorimin me efektivitet të masmedias në pasqyrimin e aktiviteteve të ekstensionit dhe përhapjen e mesazheve të ekstensionit të fermerët janë dhënë në median TV lokale 23 informacione për problematikën e kohës dhe mesazhe të ekstensionit.
- ✓ Për ofrimin e informacionit dhe këshillimit për zhvillimin teknik dhe teknologjik të fermave bujqësore me qëllim rritjen e konkureshmërisë në treg, për furnizimin me inpute, tregun, kredi, kooperimin, etj., në 7-të qendrat e informacionit bujqësor në Qarkun e Fierit janë pritur 4152 vizitorë.
- ✓ Ekstensionistët e zonave kanë kryer në terren 6372 takime individuale me fermerë dhe 411 takime me tregtarë inputesh, grumbullues e përpunuesit të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe kanë shpërndarë për fermerët 4 tituj të ri fletëpalosje me 1433 copë dhe 54 tituj të riprodhuar fletëpalosje me 1015 copë.
- ✓ Në zbatim të programit të trajnimeve të hapura me specialistë bazuar në problematikën e evidentuar, nevojat dhe kërkesat e paraqitura për trajnime nga specialistët, SEB Fier përcaktoj tematikën për trajnimet gjatë vitit 2021 dhe zhvilloj në bashkëpunim me specialistët e QTTB-ve Korçë, Lushnje dhe Fushë - Krujë gjithsej 10 tema trajnimi me pjesëmarrjen e 25 specialistëve të SEB Fier për çdo temë dhe fermerë.
- ✓ U realizua evidentimi i 3338 fermerëve intensiv, nga të cilët në Fier 2048, Lushnje 995, dhe Mallakastër 295, sipas kritereve të përcaktuar në bujqësi dhe blegtori, në nivel fshati, njësie administrative dhe rrethi.
- ✓ Gjatë muajit shkurt u realizua evidentimi i aktivitetit të 61 pikave të grumbullimit të frutave dhe perimeve në qarkun e Fierit për kapacitetet magazinuese, frigoriferike, eksportet, tregjet dhe numrin e fermerëve që bashkëpunojnë gjatë vitit 2021.
- ✓ Gjatë muajve janar-shkurt 2021 u krye mbledhja e të dhënave statistikore për treguesit në nivel ferme të prodhimit bujqësor e blegtoral, të shpenzimeve, të shitjeve, të të ardhurave, investimeve, etj., për 2522 ferma të përzgjedhura nga MBZHR në qarkun e Fierit për Vrojtimin Vjetor Bujqësor të vitit 2020. Ndërsa gjatë muajit dhjetor 2021 përfundoj mbledhja e të dhënave statistikore për treguesit në nivel ferme të prodhimit bujqësor e blegtoral edhe për 2599 ferma të përzgjedhura nga MBZHR në qarkun e Fierit për Vrojtimin Vjetor Bujqësor



- për vitin 2021, duke asistuar anketuesit për kryerjen e intervistave dhe plotësimin e pyetësorëve si dhe angazhuar për hedhjen e të dhënave në pasqyrat e programit të MBZHR.
- ✓ Në kuadrin e evidentimit të subjekteve agropërpunuese me aktivitet në qarkun e Fierit u krye listimi i 286 subjekteve agropërpunuese, nga të cilat 171 në rrethin e Fierit, 96 në rrethin e Lushnjës dhe 19 në rrethin e Mallakastrës. Janë listuar të gjitha subjekte agropërpunuese me aktivitet në përpunimin e ullirit për vaj, të perimeve dhe frutave, sallameri, mulli bloje e furra buke, prodhim të ëmbëlsirave, stabilimente e baxho për përpunimin e qumështit, prodhim vere, të pijeve jo alkolike, etj. dhe në muajin Qershor 2021 u realizua vrojtimi i 67 subjekteve të përzgjedhur nga lista në qarkun e Fierit.
  - ✓ Përfundoj hedhja në data basë të informacionit të grumbulluar nga intervistimet e kryera për Vrojtimin Pilot të Sipërfaqes së Mbjellë për 2483 fermat e përzgjedhura në Qarkun e Fierit për vitin 2021.
  - ✓ Në kuadrin e përgatitje të “Regjistrit të serave” nëpërmjet listimit të gjithë fermerëve të qarkut Fier që kultivojnë kulturat bujqësore në ambiente të mbrojtura, u evidentuan rreth 4725 fermerë për sipërfaqet në sera, kulturat e mbjella (perime, luleshtrydhe, agrume, vreshta, etj.), konstruksionin dhe tipin e serës, sistemin e ngrohjes, etj. Kjo detyrë e dhënë nga MBZHR përfundoj brenda muajit mars 2021.
  - ✓ Është realizuar planifikimi, hartimi i listës dhe pajisja me dokumentacionin i 50 fermerëve të fermave me drejtimeve të ndryshme në bujqësi e blegtori për mbajtjen e shënimeve për buxhetin e fermës. Gjatë të gjithë vitit janë asistuar fermerët e listuar për mbajtjen e llogarisë së fermës bujqësore e blegtorale.
  - ✓ Në zbatim të Udhëzimit të MBZHR nr.14, datë 20.10.2020, “Për kushtet dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të fermës” gjatë muajve maj – dhjetor 2021 është punuar në drejtim të plotësimit të Regjistrit Kombëtar të Fermës me të dhëna për identitetin e fermerit, pronësinë e tokës bujqësore, llojin dhe numrin e kafshëve bujqësore, mekanikën bujqësore, etj., për 2898 ferma në Qarkun e Fierit.
  - ✓ Në zbatim të VKM dhe Udhëzimit të MBZHR dhe MF **për skemat mbështetëse kombëtare** të vitit 2021, në janar deri në mars 2021 është punuar në drejtim të informimit të fermerëve dhe subjekteve të interesuara për skemat kombëtare që do të financohen për vitin 2021. Në datën 1-15 prill janë asistuar fermerët për të aplikuar online në SKM nga grupet e ekstensionistëve të ngritura në ndihmesë të fermerëve aplikues.
  - ✓ Ka vazhduar puna për formalizmin e fermerëve dhe plotësimin e dokumentacionit për pajisjen e tyre me NIPT fermeri. Deri më sot në nivel Qarku kanë aplikuar në DPTT Fier për tu pajisur me NIPT fermeri 21981 fermerë dhe gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021 kanë aplikuar 3078 fermerë. Rritja e numrit të aplikantëve për tu pajisur me NIPT fermeri gjatë këtij viti ka

ardhur si nevojë për të aplikuar në skemën e furnizimit me karburant për bujqësinë dhe skemave kombëtare që do të zbatohet gjatë vitit 2022.

➤ **Ndër faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa nga objektivat dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2021 do të veçonim:**

➤ Mungesa e transportit për lëvizjen e specialistëve në terren dhe monitorimin e aktiviteteve të ekstensionit.

➤ Disa aktivitete të ekstensionit në grupe ( takime në grupe, demonstrime, trajnime të hapura me fermerë dhe specialistë, etj..) nuk janë zhvilluar për shkak të gjendjes shëndetësore të një specialisti zone.

➤ Mos plotësimi i organikës së planifikuar në strukturën e SEB Fier , ku nga 29 punonjës të planifikuar janë aktualisht 26 punonjës, mungojnë 2 ekstensionistë terreni, duke sjellë për pasojë ngarkesë për disa zona dhe mos mbulim të gjitha zonave të qarkut me aktivitete të ekstensionit.

### **15. SEKTORI I BORDIT TË KULLIMIT**

Realizimi i punimeve për mirëmbajtje për vitin 2021 është si më poshtë:

Realizimi i punimeve te mirembajtjes per vitin 2021			Evidenca progresive e punimeve ne mirembajtje deri ne date 31.12.2021 per Qarkun Fier				
Mirembajtjes objekte te ujitjes dhe kullimit (art. 602)			Ecuri realizimi				
1	Objekte te mirembajtjes ne ujite	Vlera per vitin 2021 (ne leke)	Bashkia perfituese	m3 dhera te larguar	km te pastruar/ mirembajtur	ha qe i permiresohet ujitja nga mirembajtja	% e realizimit
<b>Total Ujitje &amp; Kullim Qarku</b>				<b>621,895</b>	<b>28,044</b>	<b>49,205</b>	
<b>DUK Fier Qarku</b>		<b>2,185,152</b>	<b>0</b>	<b>57,906</b>	<b>27,975</b>	<b>12,500</b>	
	Pastrimi I deges Lushnje	388,152	Lushnje	5,400	2	1,500	100
	Em.Ne LUUI-3		Lushnje	908	1		100
	Punime ne V.M.Selishte	1,078,200	Fier	33,318	1,628	10,000	100
	Punime ne Skemen Kurjan -Strum	718,800	Roskovec	18,280	26,345	1,000	100
2	Objekte te mirembajtjes ne kullim (kanale kullues, KUL, argjinatura etj)	Vlera per vitin 2021 (ne leke)	Bashkia	m3 dhera te larguar	km te pastruar/ sistemuar	ha qe i permiresohen treguesit e kullimit	% e realizimit
<b>Totali Kullim</b>		<b>43,057,528</b>	<b>0</b>	<b>563,989</b>	<b>69</b>	<b>36,705</b>	
<b>DUK Fier, Qarku</b>		<b>43,057,528</b>	<b>0</b>	<b>563,989</b>	<b>69</b>	<b>36,705</b>	
1	K-5-1-10 Terbuf	3,474,853	Lushnje	56,806	13	2,600	100
2	Lunja Karbunare	2,328,912	Lushnje	28,584	4.20	1,500	10
3	LUK 1-13	3,579,624	Lushnje	45,600	9	1,200	90
4	Argjinatura Adriatik	1,715,599	Divjake	36,327	2	1,500	100
5	K.U.L. Grabian-Bicukas	3,547,494	Divjake	50,843	9	2,500	100
6	KUL Grabian-Gradishte	4,248,467	Divjake	21,146	8.6	2,400	50
7	KUL Babunje- Gradishte	1,947,014	Divjake	19,914	4	7,600	73
8	K-6 Karavasta	531,280	Divjake			4,600	0
9	Bregdetari I Majte	5,031,600	Fier			1,500	0
10	K.U.L. Levan-Pojan	7,807,821	Fier	153,000	5	800	100
11	Kufizuesi I Majte	6,037,920	Fier	109,226	11.243	2,200	100
12	Vazhdim I KUL 2	415,640	Fier			100	0
13	Proi I Rromesit	646,920	Fier			150	0
14	Punime ne K-R-H	961,970	Fier	13,383	0.620	1,500	100
15	Kanali Kullues K-122,Patos	782,414	Patos	10,885	1.429	250	100
16	Emergj.ne Prron e Dukasit, Patos		Patos	1,127	0.145	60	100
17	Em.ne K-17,Fr		Fier	3,874	0.47	80	
18	Em.ne K-12,Burgu, Fr		Fier	2,774	0.47	15	
19	Emergjence ne Argj.Pisheporo, Fr		Fier	2,500	0.20	500	
20	Emergjence ne KMU		Fier	500	0.100	150	
21	Emergjence ne Hidrovoret Povelce e Seman		Fier	5,000	0.20	3,000	
22	Emergjence ne Hidrovorin Terbuf		Lushnje	2,500	0	2,500	

## 16. AUTORITETIN KOMBËTAR I USHQIMIT, FIER

Misioni kryesor i AKU-së është garantimi i shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtja e konsumatorit. Të vendosë dhe të konsolidojë në vijimësi bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesat e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar dhe në të gjitha fazat e trajtimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë.

### ❖ **Spektori i Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OBU-ve**

Gjatë Vitit 2021, Spektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor, ka kryer inspektime bazuar në planin e inspektimit sipas kategorizimit të bizneseve me bazë risku, në bazë të madhësisë dhe të largësisë, të hartuara nga Drejtoria Rajonale Qarku Fier dhe të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë. Gjatë viti 2021 u planifikuan 2355 inspektime.

#### • **Arsyet specifike për mosrealizimin e këtij plani me bazë risku janë:**

1. Inspektime të kërkesave për pajisje me licencë nga ana e subjekteve.
2. Inspektime të rasteve të denoncimeve.
3. Inspektime për miratim paraprak për pajisje me Nr. NIPT të njësive të tregtimit të mishit.
4. Inspektime sipas kërkesave të ardhura për aplikimet IPARD II
5. Inspektime sipas kërkesave për pajisje me leje higjieno-sanitare të ambienteve dhe të mjeteve të transportit.
6. Numër i pa mjaftueshëm të inspektorëve për realizimin e planit 100%
7. Inspektime për marrje mostre sipas planit të monitorimit të mbetjeve të pesticideve në fruta perime .
8. Raste nga sistemi alert RASSF
9. Inspektime me Urdhër nga DPAKU
10. Bashkëpunim ndërinstytucional
11. Raste me kërkesë nga OBU për asgjësime / zhblllokim aktiviteti

#### ❖ **Plani i marrjes së mostrave ,realizimi i tyre si dhe arsyet specifike për mos realizimin e tyre.**

Plani i marrjes së mostrave për vitin 2021 është përcaktuar që në fillim të vitit dhe është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme .

- Mostra të planifikuara mikrobiologjike	541	mostra
- Analiza të planifikuara mikrobiologjike	1 015	analiza
- Mostra të planifikuara fiziko kimike	300	mostra
- Analiza të planifikuara fiziko kimike	987	analiza
- Mostra të marra mikrobiologjike	333	mostra
- Analiza të kryera mikrobiologjike	339	analiza
- Mostra të marra fiziko-kimike	170	mostra
- Analiza të kryera fiziko-kimike	530	analiza

- **Për sa i përketë mosrealizimit të këtij plani të marrjes së mostrave duhet të përmendim disa arsye:**
  - Mungesë e theksuar e pajisjeve dhe kushteve për të bërë të mundur procesin e marrjes së mostrave pranë OBU-ve.
  - Në periudhën Korrik-Gusht ka pasur mungesë të punonjësve për arsye të pushimeve vjetore.
  - Pranë Laboratorit Rajonal ka pasur një numër të limituar terrenesh dhe jemi munduar që në bashkëpunim me sektorin e laboratorëve të merren aq mostra sa nr. terrenesh disponohen.
  - Edhe pse janë të planifikuar për tu marrë mostër një pjesë e OBU kanë rezultuar që kanë mbyllur aktivitetin.
  - Gjatë inspektimeve sidomos në periudhën korrik-gusht janë gjetur shumë subjekte prodhuese të mbyllur si rezultat i pushimeve vjetore.
  - Gjatë inspektimeve janë konstatuar që disa OBU nuk kanë pasur produkt ose kanë qenë akoma në procese maturimi.
  - Një pjesë e OBU kanë qenë të mbyllur dhe për arsye të infektimit me Covid-19.
  - Për të rritur numrin e mostrave në 3 muajt e fundit janë dërguar pothuajse të gjithë mostrat për analizim pranë ISUV.
- ❖ **Problematikat e evidentuara nga Sektori Ushqimit për 2021**

Gjatë periudhës Vitit 2021 janë konstatuar problematika si më poshtë:

- Mungesë e informimit të OBU mbi legjislacionit në fuqi.
- Në punën e përditshme ka problematika me funksionimin e pajisjeve (ipad) gjatë inspektimeve si dhe mungesa e internetit gjë që vështirëson punën e inspektoreve dhe krijon vonesa të cilat janë të vështira për tu rikuperuar në kryerjen e inspektimit të radhës.
- Me bashkimin e sektorëve kemi një numër më të lartë të punonjësve të mjeteve transportuese. Për këtë arsye punohet me 2 grupe pune në një mjet transportues. Kjo krijon vonesa në mbërritjen në destinacion.
- ❖ Ka mungesë të pajisjeve dhe metodikës për marrjen e mostrave të planifikuar sipas planit të mostrave.
- ❖ **Sektori i Koordinimit të kontrollit të mbrojtjes së bimëve dhe Imputeve Bujqësore**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve, ka kryer inspektime bazuar në planin e inspektimit sipas kategorizimit të bizneseve me bazë risku, në bazë të madhësisë dhe të largësisë të hartuara nga Drejtoria Rajonale Qarku Fier dhe të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë. Gjithashtu janë kryer dhe inspektime jashtë planit sipas rasteve specifike të ardhura.

-Numri total i inspektimeve të planifikuara 888 inspektime.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 janë kryer 34 inspektime jashtë plani.

Problematikat e konstatuara gjatë realizimit të kontrolleve zyrtare, zgjidhjet e ofruara.

-Ka pasur problematika me numrin e kufizuar të inspektorëve për arsye shëndetësore apo të marrjes së lejes vjetore. Kjo ka ndikuar në realizimin e planit.

-Gjatë periudhës Janar-Maj 2021 sektori ka punuar me një grup inspektorësh sepse 1(Një) inspektore ka qenë me leje lindje.

-Urdhërat e ardhur nga DP.

*Plani i marrjes së mostrave për vitin 2021 është përcaktuar që në fillim të vitit dhe është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme. Në bazë të këtij plani sektori i inspektimeve të Mbrojtjes së Bimëve e ka realizuar planin e marrjen së mostrave për analizim. Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë marrë 88 mostra.*

## **Sektori i Shërbimeve të Brendshme**

Në Janar – Dhjetor 2021 ka patur gjithsej **39 gjoba**, me vlerë **6 840 000 lek**. Nga të cilat **2 gjoba** me vlerë **400 000 lekë** janë falur nga Komisioni i Animimit të gjobave pranë DPAKU Tiranë, **6 gjoba** me vlerë **610 000 lekë** janë derdhur vullnetarisht, pjesa tjetër pritet konfirmim nga DPAKU për tu ndjekur procedura ligjore.

Nga debitorët e prapambetur janë arkëtuar nga derdhjet vullnetare, nga akt-marrëveshje dhe nga zyra përbarimore vlera prej **2 646 400 lekë**, janë falur me komision të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU Tiranë 3 000 000 lekë gjoba të viteve të më parëshme. Pjesa tjetër prej **74 175 260 lekë** janë ne proces ekzekutimi, për kërkesa për urdhër ekzekutim apo ne pritje te konfirmimeve të DPAKU Tiranë.

### **G. Në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale :**

1. Drejtoria e Spitalit Rajonal
2. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
4. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

### **17. DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL, FIER**

Misioni është të ofrojë shërbim sa më të mirë dhe sa më cilësor për pacientët.

Objektivat kryesorë të Spitalit Rajonal Fier kanë qenë:

- ✓ Rritja e cilësisë së shërbimeve spitalore,
- ✓ Mbulimi i shërbimeve spitalore me mjeke specialist,
- ✓ Zbatimi me korrektësi i sistemit të referimit,
- ✓ Menaxhimi i situatave, gatishmëria e stafit mjekësor , infermieror për menaxhimin e situatave të krijuara nga pandemia ,nga përmytjet etj
- ✓ Përgjigja në kohe ndaj nevojave te qytetareve ,
- ✓ Rritja e cilësisë së shërbimit, menaxhimit të barnave dhe materialeve të mjekimit, materialeve mbrojtëse etj.
- ✓ Menaxhimi sa më efikas i burimeve njerëzore që janë patur në dispozicion me qëllim mbulimin sa më të mirë të shërbimeve spitalore dhe jo vetëm.

- ✓ Është arritur që shërbimet spitalore të mbulojnë nga mjekët specialist të Spitalit Rajonal Fier. Janë përforcuar: shërbimi i neurologjisë (aktualisht kemi dy mjekë specialist), shërbimi i Imazherisë (aktualisht ka dy mjekë specialist), Shërbimi i Onkologjisë (2 mjekë specialist), përforcuar shërbimi i pediatriisë (janë lidhur kontrata 3 vjeçare me 3 mjekë specialist pediater), shërbime të cilat më parë mbulohehin me ndihmën e patronazhimit të Spitalit të Traumës Tiranë.
  - ✓ Gjithashtu dhe punësimi i stafit infermieror nga portali "Infermiere për Shqipërinë", ka bërë që vendet vakante të plotësohen në një kohë shumë të shkurtër duke rritur performancën dhe cilësinë e këtij shërbimi.
  - ✓ Spitali Rajonal Fier ka përforcuar shërbimin e informacionit nëpërmjet punonjësve të recepsionit të cilët sqarojnë dhe orientojnë pacientet që paraqiten në Spitalin Rajonal Fier. Punësimi i tyre është realizuar me kontrata provizore dhe paguhen nga të ardhurat që ka realizuar vetë Spitali nga Shërbimet që ofron gjithsej 6 punonjës.
  - ✓ Numri i punonjësve sipas strukturës ka qenë 524 punonjës. Por me transferimin e Shërbimit të Hemodinamikes nga Spitali Rajonal Fier në Spitalin Rajonal Memorial Fier, kalimi i shërbimeve laboratorike tek koncesionari dhe shërbimin e lavyerisë tek private aktualisht struktura nga 524 punonjës është reduktuar në 486 punonjës .
- **Nr. i të shtruarve për vitin 2021                      42143 pacientë**

**Objekti i Spitalit Rajonal Fier është plotësimi i vendeve vakante dhe forcimi i shërbimeve me mjekët specialist si me poshtë:**

Anestezi-Reanimacion	<b>2</b>
Diagnoza me Imazhe	<b>1</b>
Kardiologji	<b>1</b>
Pneumolog	<b>1</b>
Obstetrike-Gjinekologji	<b>1</b>
ORL	<b>1</b>
Pediatri	<b>1</b>
Sëmundje Infektive	<b>1</b>
Neonatologji	<b>1</b>
Toksikolog	<b>1</b>
Mjek Urgjence	<b>1</b>
Mjek Kirurg Urolog 1	<b>1</b>

## **18. NJËSITË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Në Qarkun Fier operojnë Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor :

1. NJVKSH, FIER
2. NJVKSH, LUSHNJË

### 3. NJVKSH, MALLAKASTËR

#### **NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR FIER**

Objektivat kryesore për vitin 2021 ishin :

##### **1- Eficencë maksimale në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të akorduar për vitin 2021.**

Ky objektiv është realizuar 100%.Me ardhjen e buxhetit të akorduar për vitin 2021 nga MSHMS, financa e NJVKSH Fier ka mundur të planifikim dhe zbatim të buxhetit në funksion të nevojave reale të sektorëve duke respektuar në maksimum prioritetet siç ishte plotësimi i bazës materiale të sektorëve veçanërisht të sektorit të Epidemiologjisë duke mundur pajisjen e personelit shëndetësor me bazë materiale të nevojshme me mjete mbrojtëse anti Covid-19.

##### **2-Raportim në afat të informacioneve të kërkuara në DROSHKSH Vlorë, MSHMS,dhe instancave eprore.**

NJVKSH Fier ka qenë gjithmonë korrekte në raportimin në kohë të informacionit të kërkuar. Ajo ka raportuar të gjitha evidencat me vërtetësi dhe informacionet në kohë reale dhe pa zvarritje.

##### **3-Rritja e gatishmërisë për t'ju përgjigjur në kohë sektorëve me shërbime transporti dhe mirëmbajtjeje.**

Me përgjegjësi është punuar edhe nga shoferi i institucionit tone i cili ka bërë të mundur sigurimin e transportit në çdo kohë të punonjësve, për kontrollin dhe funksionimin normal të punës në të gjitha zonat. Përparësi i është dhënë edhe mbajtjes në gatishmëri të automjeteve sidomos në funksion të Sektorit të Epidemiologjisë në këtë periudhë të vështirë Pandemie, si dhe duke siguruar një bashkëpunim dhe koordinim të mirë të punëve me të gjithë sektorët.

##### **4-Ndjekja me përparësi e të gjithë problemeve ekonomiko-financiare duke u ingranuar me legjislacionin në fuqi.**

Ky objektiv është në qendër të vëmendjes nga punonjësit. Përditësimi me ndryshimet në Aktet normative dhe kryerja e aktiviteteve financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ka qenë gjithmonë prioritet dhe në qendër të vëmendjes gjatë vitit 2021.

#### **NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR, LUSHNJE**

- Ofrimi i shërbimeve nga QSH bëhet sipas paketës bazë të KSHP. Në të gjitha QSH është ofruar shërbimi shëndetësor prej mjekut të familjes dhe infermierëve të KSHP për të gjitha kategoritë e popullatës. QSH kane një përqindje realizimi të indikatorit domethënës.
- **Referimet tek mjeku specialist** –Në vitin 2021 është përcaktuar numri më i lartë të referimeve nga Mjeku i Familjes drejt Mjekut specialist me 14 %
- **Indikatorët e Performancës në KSHP për Shëndetin e Nënës** - përqindjen më të lartë të depistimit të grave mbi 35 vjeç për Ca gjiri në nivel qendre shëndetësore e ka Qsh Allkaj
- **Indikatorët e Performancës në KSHP për Shëndetin e Fëmijës** - Në nivel QSH ka % realizimi të lartë dhe në nivel NJVKSH mesatarisht 94%.



- **Indikatorët e Performancës në KSHP për Sëmundshmerinë Kronike** - Sëmundjet kronike përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të sëmundshmërisë në KSHP. Më të hasurat brenda këtij grupi janë **Diabeti, Hipertensioni arterial, Asthma, Sëmundjet kardiovaskulare** etj.
- **Indikatorët vjetor të performancës për shëndetin nëna dhe fëmija** -Vdekshmëria neonatale 0.2% -Vdekshmëria foshnjore 0.3% -Vdekshmëria e fëmijëve 0-5 vjeç 0.4% -% e lindjeve të gjalla me peshë nën 1.9%.
- Gjatë vitit që kaloi puna e investimeve u fokusua në rikonstruksionin e dy objekteve, qendra shëndetësore Tërbuf e Këmishtaj, investim ky I kryer nga MSHMS.
- ***Janë hasur problematika me kryerjen e kontrollit mjekësor bazë në disa qendra shëndetësore ,përkatësisht QSH Tërbuf dhe QSH Gradisht për arsye se gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetin e tyre në ambiente me qira sepse godina e tyre i është nënshtruar rikonstruksionit. Gjithashtu QSH Ballagat edhe QSH Hysgjokaj, kontrollin mjekësor bazë e realizojnë me makinën lëvizëse.***
- Njësia vendore e kujdesit shëndetësor i është gjendur pranë qytetarëve të cilët kanë pasur nevojë për shërbim duke i ofruar shërbimin e kryerjes së tamponëve që qytetarët të mund të kuroheshin në kohë. Është ofruar dhe shërbimi i vaksinimit për të parandaluar infektimin me COVID. NJVKSH Lushnje ka kryer **24800** teste dhe PCR nga te cilat **5301** kane rezultuar pozitiv dhe 19499 kane rezultuar negativ.
- Janë aplikuar gjithsej **106475 doza vaksine COVID**, nga te cilat 50569 janë dozë e I, 46937 janë dozë e II dhe 8969 janë dozë e III.
- Vaksinat e aplikuara janë të ndara në 4 lloje, 17469 vaksina të aplikuara janë Astra Zeneca, 32885 janë Pfizer, 56500 janë Sinovac dhe 5034 janë Sputnik.

## **NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR MALLAKASTËR**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, njësia zhvilloi aktivitetin e saj duke u fokusuar në përmbushjen e detyrave funksionale, realizimin me efikasitet të planeve të punës, objektivave dhe detyrimit ndaj qytetarëve për ofrimin e shërbimit shëndetësor bazë dhe rritjen e kujdesit për shëndetin e popullatës.

Në vazhden e epidemisë kombëtare të shkaktuar nga virusi SarsCov-2 NjvKSh Mallakastër është përballur me ngarkesë të punëve duke qenë gjatë gjithë kësaj kohe në gatishmëri konstante për të përket diagnostikimit të rasteve me Covid-19 dhe po ashtu aplikimit të vaksinave ndaj SarsCov-2 në kuadër procesit të pandërprerë të vaksinimit. Për marrjen e masave në kohën e duhur për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga SarsCov-2, institucioni në bashkërendim me organet eprore, ka vendosur për mbylljen e disa institucioneve kur është parë e nevojshme.

Pas punës së kryer për vlerësimin, hetimin dhe gjurmimin epidemiologjik të rasteve Suspekt me Covid-19 në rrethin e Mallakastrës, NjVKSh Mallakastër ka vazhduar pa ndërprerje monitorimin e gjendjes shëndetësore duke kryer vlerësimet epidemiologjike dhe analizimin e herëpashershëm të situatës.

Në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe instancat e tjera, është bërë e mundur izolimi i rasteve të mundshme dhe dezinfektimi i ambienteve të tyre të banimit, po ashtu me karantinimin dhe identifikimin e personave të kontaktit dhe atyre të cilët kanë qenë të ekspozuar. Përgjatë vitit 2021 janë marrë afërsisht rreth **7,825** (shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e pesë) mostra nazo-faringeale personave të dyshuar, referime këto nga Mjekët e Familjes, Urgjenca Kombëtare 127 dhe vlerësimet epidemiologjike të NjVKSh Mallakastër. Këto teste janë kryer si nëpërmjet testeve të shpejta të antigenit ashtu edhe sipas testimit molekular nëpërmjet metodës PCR. Të ndara sipas llojit, testet e kryera paraqiten si vijon:

1-Teste të shpejta të antigenit/Rapid Test:	<b>5,186</b>
2- Teste molekulare PCR/ rRT-PCR:	<b>2,639</b>
<b>Total teste të kryera =</b>	<b>7,825</b>

Periudha	Total Mostra Covid-19 NjVKSh Mallakastër – Viti 2021		
	Testime Total	Pozitiv	Negativ
<b>01.01.2021 - 31.12.2021</b>	<b>7,825</b>	<b>1,688</b>	<b>6,137</b>

#### Të dhënat për vaksinim

Vaksinimi Progresiv ndaj Covid-19			
Total Vaksina të kryera	Doza të para	Doza të dyta	Doza të treta
<b>21,090</b>	<b>10,189</b>	<b>9,529</b>	<b>1,372</b>

Në raport me numrin e popullsisë të mundshme për t'u vaksinuar, Mallakastra ka arritur një përqindje prej 54% të mbulesës vaksinale të popullatës së vaksinuar duke arritur dhe kaluar objektivin e vendosur nga Ministria e Shëndetësisë.

- Në pikat e monitorimit të ujit të pijshëm janë marrë çdo kohë sipas përcaktimeve analiza fiziko-kimike të ujit, dhe nuk ka rezultuar asnjë prej analizave me probleme.
- Janë marrë 11 (njëmbëdhjetë) mostra kripe/muaj në subjektet e ndryshme me qëllim analizimin e tyre dhe kontrollin e vlerës së lejuar për jodin. Nga monitorimet e kryera, niveli i jodit ka qenë në përputhje me parametrat e kërkuara.

Në mënyrë progresive, deri në muajin dhjetor të vitit 2021 janë realizuar të ardhura sipas tabelës së mëposhtme:

Periudha	Të ardhurat Dytësore	Të ardhurat nga gjrobat	Të ardhura gjithsej
Janar – Dhjetor 2021	59,900	92,680	152,580

**Problematikat:**

- Në institucion **nuk është prezent një Laborator mikrobiologjik** ku mund të kryhen analizat mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Aktualisht kampionet e marra dërgohen në Laboratorin mikrobiologjik pranë NJVKSh Fier. Janë bërë shkresa zyrtare drejt institucioneve eprore për zgjidhje të mëtejshme për mungesën e laboratorit mikrobiologjik në NJVKSh Mallakastër.
- Problem shqetësues është **plotësimi i vendeve vakante me staf shëndetësor**, kryesisht në zonat e fshatrave larg qendrave urbane. Kjo mungesë e personelit mjekësor sjellë një mbulim jo të mirë të shërbimit shëndetësor bazë në të gjithë territorin duke sjellë ngarkesa në ofrimin e këtij shërbimi për banorët e Mallakastrës.

**19. INSPEKTORIATI SHETËTOR SHËNDETËSOR**

Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: “Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik”.

❖ **Objektivat e ISHSH për vitin 2021:**

- ✓ Kryerja e inspektimeve bazuar në programin vjetor të miratuar.
- ✓ Inspektimi i subjekteve bazuar në kërkesat, ankesat dhe denoncimet drejtuar ISHSH drejtpërdrejt në institucion apo nëpërmjet portaleve.
- ✓ Kryerja e inspektimeve të përbashkëta.
- ✓ Kryerja e inspektimit nëpërmjet portalit “e – inspektim”, duke ju përmbajtur rregullores së miratuar për mënyrën e funksionimit të tij.
- ✓ Informimi i publikut për veprimtarinë e inspektimit.
- ✓

❖ **Inspektimet e kryera për Vitin 2021:**

Për Vitin 2021, me miratim të MSHMS dhe Inspektoratit Qendror, për ISHSH Qarku Fier u miratua plani vjetor i punës me numër inspektimesh **1656**, inspektime që do të kryheshin në bazë të tematikave mujore dhe fushave të inspektimit të miratuar.

*Për shkak të gjendjes së krijuar nga Covid -19 dhe numrit të lartë të rasteve 6 mujorin e parë të 2021, me dakordsinë e Inspektoratit të Përgjithshëm, u vendos që plani i punës për këto muaj të ishte përkatësisht: janar 20%, shkurt 20%, mars 50 %, prill 20 %, maj 30%, qershor 80 % dhe 6 mujorin e dytë me 100% të planit të miratuar.*

Në total plani vjetor prej **1656** subjektsh do të realizohej në masën **68%**.

Gjatë vitit u krye inspektimi bazuar në planin e punës të miratuar dhe plani u realizua në masën **89 %**, duke tejkuluar me **21 %** totalin e inspektimeve të parashikuara për tu inspektuar.

#### **FUSHAT E ZBATIMIT SIPAS TIPIT TË INSPEKTIMIT**

- Inspektime sanitare
- Inspektimi i kujdesit ambulator
- Inspektimi i burimeve të rrezatimit
- Inspektime të kujdesit spitalor
- Inspektime stomatologjike
- Inspektime të tjera

Si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga Covid-19, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka pasur në fokus inspektimet dhe monitorimet për zbatimin e protokolleve të miratuara ISHP bazuar në Urdhrat e dala nga MSHMS.

Inspektimi ka konsistuar në **këshillimin, paralajmërimin** dhe në raste përsëritje të shkeljeve edhe **ndëshkimin** e subjekteve të cilat kanë rezultuar me shkelje gjatë kontrolleve të ushtruara.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka operuar që prej muajit janar deri në muajin dhjetor 2021, duke ushtruar kontrolle gjatë orarit zyrtar të punës, pas orarit zyrtar dhe gjatë fundjavave.

**Gjatë vitit u kryen 23330 monitorime dhe 792 inspektime**

**ku janë vendosur 261 masa paralajmërim, 153 Vendime të Ndërmjetme për mbyllje provizore të pjesshme, totale apo marrjen e masave urgjente dhe 3 masa administrative.**

Sanitari	Inspektim	Ri-inspektim	Masa Adm.	Vlera/Leke	Vendime	Paralajmërimë
Akomodim	17	2	0	0	0	2
Gastronomi	0	0	0	0	0	0
Bare	0	0	0	0	0	0
Prodhime Ushqimore	0	0	0	0	0	0
Shumica	0	0	0	0	0	0
Pakica	0	0	0	0	0	0
Uji I Rrjetit	120	0	0	0	0	0
Kozmetika	146	80	0	0	0	82
Pijet	0	0	0	0	0	0
Pishinat	1	0	0	0	0	0
Social Kulturore	2	0	0	0	0	0
Arsimi	260	2	1	30,000	0	17
IVDVP	2	0	0	0	0	1
Shëndeti ne Pune	59	13	0	0	0	14
Duhani	73	0	0	0	0	0
Alkooli	0	0	0	0	0	0
Produk. zv te QGj	63	0	0	0	0	0
Uji I Ambalazhuar	0	0	0	0	0	0
DDD	0	0	0	0	0	0
Kripa e Joduar	25	0	0	0	0	0
Te Tjera	20	1	0	0	0	1
Farmacit	75	8	0	0	0	9
Q.kujdesit fëmijëve	0	0	0	0	0	0
Qend. kujdesit te Moshuarve	1	0	0	0	0	0
COVID-19	0	0	0	0	0	0
<b>Shëndetëson</b>	<b>539</b>	<b>34</b>	<b>3</b>	<b>330,000</b>	<b>4</b>	<b>141</b>
Kabinet Dentar Pub.	0	0	0	0	0	0
Klinika Mjekësore jo Publike	29	13	0	0	0	12
Shërbimi Urgjencës	0	0	0	0	0	0
Klinika Dentare Jo Publike	126	12	0	0	0	17
Lab. Mjekësor Jo Publike	28	5	1	30,000	1	9
Shërbimi Parësor	346	3	1	200,000	3	101
Shërbimi Spitalor	6	1	1	100,000	0	2
Rrezatimi Jonizues	0	0	0	0	0	0
Akreditimi	4	0	0	0	0	0
<b>Shuma</b>	<b>1403</b>	<b>140</b>	<b>4</b>	<b>360,000</b>	<b>4</b>	<b>267</b>
<b>Monitorim Duhani</b>	2408					
<b>Monitorim Alkooli</b>	0					

## 20. DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier , ka zhvilluar aktivitetin e saj mbi bazën e Planit Vjetor 2021 të Miratuar nga DPSHSSH, mbi të cilën është programuar gjithë aktiviteti i drejtorisë me sektorët e saj:

- I- Sektori i Pranueshmërisë
- II- Sektori i Shërbimeve Sociale dhe IT

*Synimi i gjithë punës është: Garantimi i shërbimeve shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit e përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. Zbutja e varfërisë si dhe të krijohet mundësia për integrimin e kësaj kategorie, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për integrimin dhe përmirësimin e jetesës së tyre.*

### ECURIA E SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE

*Në dhjetor 2021, rezultuan me **ndihmë ekonomike 2410 familje** në muaj ose afërsisht **1.8 %** e numrit të familjeve të prefekturës:*

*Për Qarkun Fier ka patur këtë dinamikë vjetore të shtrirjes së skemës së re të ndihmës ekonomike:*

*Në muajin Dhjetor **2615** aplikime në total , prej të cilëve **2410 përfitues**, dhe **205 jo përfitues**.*

*Nëse shohim ecurinë vjetore të skemës së ndihmës ekonomike, shihet **se 91 % e individëve që aplikuan rezultuan përfitues nga sistemi i ndihmës ekonomike**.*

*Në kohën e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, është vënë re një numër i lartë nevojash që ka kjo kategori për ndihmë, si dhe nga ana tjetër një mbështetje e madhe për këtë kategori nga ana e qeverisë.*

- ❖ *Për vitin 2021 ishin planifikuar gjithsej 22 kontrolle, sipas Planit të Veprimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror. Nga 22 kontrolle të planifikuara janë realizuar 20 kontrolle, ndërsa 2 kontrolle nuk janë realizuar, kjo për shak të largimit të administratorëve social.*
- ❖ *Për vitin 2021 rezulton se nga grupi i kontrollit të Drejtorisë Rajonale janë kryer 68 verifikime në banesë për të parë përputhshmërinë me deklarinimin e bërë pranë administratorit shoqëror.*
- ❖ *Janë zhvilluar 4 takime kualifikuese me administratorët shoqëror të Qarkut Fier.*

***Problematikë janë pagesat me sistem bankar.*** Nuk ka një praktikë unifikuese se si mund të ndiqet kjo procedure.

<i>Kategoritë</i>	<i>Paaftësi</i>	<i>Verbëri</i>	<i>Paraplegji</i>	<i>Invalidë Pune</i>
<i>Individë/fondi total</i>	<i>5648 / 745 kujdestarë</i>	<i>1689 / 397 kujdestarë</i>	<i>913/ 908 kujdestarë</i>	<i>7088</i>

- ❖ Për vitin 2021 kanë përfituar paaftësinë **5648** persona ku prej tyre **745** trajtohen me kujdestarë, **1689** të verbër ku **395** prej tyre me kujdestarë, **913** paraplegjikë ku prej tyre **908** trajtohen me kujdestarë, **7088** persona paguhen si invalidë pune.
- ❖ Invalidë pune janë kontrolluar 1304 dosje.

*\*Në Qarkun Fier DRSHP ka 3 Zyra Punësimi :*

*Z.P Fier që përfshin Bashkinë Fier, Bashkinë Patos dhe Bashkinë Roskovec*

*Z.P Lushnjë që përfshin Bashkinë Lushnje dhe Bashkinë Divjakë.*

*Z.P Mallakastër që përfshin Bashkinë Mallakastër.*

<i>Nr</i>	<i>Bashkia</i>	<i>Nr. Persona të referuar për punësim</i>	<i>Nr. Persona të punësuar</i>
<b>1</b>	<b>Fier</b>	<b>1294</b>	<b>18</b>
<b>2</b>	<b>Lushnje</b>	<b>870</b>	<b>77</b>
<b>3</b>	<b>Mallakastër</b>	<b>1480</b>	<b>11</b>

*Është ndërmarre iniciativa për nxitjen dhe bashkërendimin e procesit të hartimit të planeve sociale, si një mjet i rëndësishëm në ngritjen e fondeve dhe ofrimin e shërbimeve; me të gjitha bashkitë e Qarkut Fier*

Janë zhvilluar tryezat teknike për ngritjen e mekanizmit të koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në të 6 – ta bashkitë e qarkut Fier. Aktualisht në të gjitha bashkitë e qarkut Fier, në bashkëpunim me PNUD- in janë ngritur dhe funksionojnë të gjitha MKR- të. Gjithashtu funksionojnë dhe Ekipet Teknike Ndërsektoriale ( ETN- të).

#### **H. Në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit**

1. Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
2. Drejtoria Rajonale e Mjedisit

## **21. ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA**

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka si mision monitorimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese të zonave mjedisore të mbrojtura; menaxhimin e tyre në mbështetje të kërkesave të kohës dhe standardeve ndërkombëtare.

### **Aktivitetet kryesore të realizuara për vitin 2021 në drejtim të menaxhimit të ZM-ve të reja;**

- Menaxhimi dhe monitorimi i vazhdueshëm për mbrojtjen e ZM dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në ZM
- Aktivitete edukimi dhe ndërgjegjësimi për mjedisin me shkollat që ndodhen brenda dhe jashtë ZM.
- Bashkëpunimi me Projektin JICA
- Promovim nëpërmjet televizioneve dhe materialeve informuese, të vlerave natyrore, historike dhe të traditës të ZM .
- Organizimi i eventeve sensibilizues në kuadër në Ditën e Pelikanit Kaçurrel dhe ditëve mjedisore.
- Marrja pjesë në takime me përfaqësues të Institucionit të Prefektit Fier dhe bashkive Fier, Lushnje , Mallakastër, Divjake mbi planin e masave të emergjencave civile dhe planit të masave të për sezonin turistik 2020.
- Lidhja e kontratave me subjektet që operojnë në park dhe 2 zonat e mbrojtura
- Mirë menaxhim për qendrën e vizitoreve .
- Zgjerimin e sipërfaqes pyjore të parkut në pjesët ranore ku janë lënë bosh pas tërheqjes së detit .
- Mirëmbajtjes në ishullin e pelikanit për sezonin e çeljes së vezëve .
- Guida me turistë vendas dhe të huaj për promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të zonës
- Plotësimi i protokolleve mbi faunën e egër dhe numërimi periodik për çdo muaj .
- Mbrojtja nga zjarret duke ngritur grupet vullnetare të zjarreve me në krye kryepleqtë e fshatrave, përdorimi i kullave për vërtetimin nga zjarri .

### **Monitorimet**

- Parku Kombëtar Divjake –Karavasta 2421 monitorime
- RNM Pish Poro- 614 monitorime
- RNM Levan - 154 monitorime
- MN 293 monitorime

### **NUMRI I VIZITOREVE & TURISTEVE DHE TË ARDHURAT**

**Periudha: Janar-Dhjetor 2021**



Parku Kombetar Divjake-Karavasta, RNM Pish Poro dhe RNM Levan janë zona shume te frekuentuara nga vizitoret vendas dhe te huaj, sidomos ne periudhën e verës. Tabela e mëposhtëme tregon ne shifra numrin e vizitoreve te cilët frekuentuan parku gjate 2021.Numri i vizitoreve ishte pothuajse i njëjtë me vitin 2019, por edhe duke lënë pas një vit te mbrapsht si 2020.

Nr	Qarku	Bashkia	Emërtimi i Zonës se Mbrojtur	Vendas	Te huaj	Numri Total
1	Fier	Divjake	Parku Kombetar Divjake-Karavasta	468500	46500	515000
2	Fier	Fier	Bregdet Pish Poro	378560	21400	399960
3	Fier	Fier	Levan	37300	9220	46520
<b>Totali Ad.ZM Fier</b>				<b>884360</b>	<b>77120</b>	<b>961480</b>

## PROBLEMATIKAT

- Ngërçi administrativ me Bashkinë Divjakë .
- Peshkimi pa kriter në Lagunën e Karavastës është një tjetër problematikë.
- Lidhja e kontratave me subjekte që zhvillojnë aktivitetin e tyre ne Park . (te paqarta pronësitë)
- Vakumi ligjor I ligjit 81/2017(mungese e akteve n/ligjore)
- Saktësimi i kufijve në RNM Pish Poro dhe RNM Levan, plotësimi me hartat treguese.
- Mungesa e një listë pronarësh brenda territorit te ZM Qarku Fier (kadastra Fier nuk ka bashkëpunuar)

## 22. AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT, FIER

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë ushtron funksionet e saj në këto tre qarqe.

### ❖ Fusha e Veprimtarisë dhe Objektivat

- Mbikëqyr dhe mbron territorin e të gjithë rajonit
- Organizon punën e ARM-së dhe shpërndan detyrat sipas objektivave specifike të secilit punonjës;

- c) Bashkëpunon me ARM-të e tjera dhe mbështet punën e AKM-së në lidhje me aplikime, monitorime, inspektime që kanë të bëjnë me rajonin përkatës;
- d) Harton programin vjetor të inspektimit dhe ja dërgon për miratim Drejtorit të ARM-së.

❖ **Spektori i inspektimit mjedisor**

ka realizuar objektivat si më poshtë:

SEKTORI I INSPEKTIMIT MJEDISOR			
Inspektime Qershor-Dhjetor 2021	Procedura Asgjësimi	Ankesa	Inspektime jashtë programit
212	15	40	7

❖ **Spektori i lejeve mjedisore**

ka realizuar objektivat si më poshtë:

Dhënie mjedisi A dhe B	Mendimi për leje	Dhënie Paraprake/Thelluar	Mendimi për VNM	Aplikime për Dëgjësë me publikun
210		219		104

❖ **Spektori i inspektimit të burimeve natyrore dhe ujërave**

Ka realizuar objektivat si më poshtë:

- Përpunim të database për subjektet e pajisur me leje shfrytëzimi të burimeve ujore për të 3 Qarqet
- Evidentim të zonave dhe subjekteve që bëjnë shkarkime të ndryshme në mjedise të ndryshme
- Sensibilizim i shoqërisë mbi situatën pandemike në vend

**Problematikë : Gjatë periudhës qershor - dhjetor 2021, për shkak të mungesës së logjistikës por dhe situatës pandemike në vend nuk janë realizuar më inspektime.**

SEKTORI I INSPEKTIMIT TE BURIMEVE NATYRORE DHE UJRAVE		
Inspektime total	Masa administrative	Ankesa
84	9	2

❖ **Spektori i monitorimit**


Spektori i Monitorimit ka vlerësuar që të gjitha monitorimet që kanë ardhur gjatë gjithë vitit nga subjektet kanë qenë brenda kushteve të lejeve mjedisore.

Gjithsej **49** monitorime, nga të cilat:

- a) 2 tipi A;
- b) 12 tipi B;
- c) 35 tipi C.


➤ **Problematikë mbetet : Menaxhimi i mbetjeve.**

- **Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier** ka ndjekur ecurinë e zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.  
Qarku Fier përbëhet nga 6 bashki të cilat tashme kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, dhe gjatë viti 2021 janë kryer 3 Rishikime të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të Përsheptuar: Bashkia Fier (1) dhe Bashkia Roskovec ( 2 )
- Është kryer kontrollin Periodik i Zhvillimeve në Territor për të gjashtë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Ky kontroll kryet në muajin Mars të çdo viti, për virin paraardhës.
- Plani i përgjithshëm vendor zbatohet nëpërmjet Planeve të Detajuara Vendore - PDV



#### ❖ Investimet

Për vitin që lamë pas Qarku Fier ka pas 2 investime të rëndësishme.



Spitali Rajonal Memorial ka filluar punimet në fillim të vitit dhe ka përfunduar brenda afateve të parashikuara.

Për sa i përket Inceneratorit dhe Landfillit të Përpunimit të Mbetjeve, është ndjekur ecuria e fillimit të punimeve, të testimeve paraprake të Inceneratorit Fier e deri në nxitjen e lidhjes së kontratave me secilën njësi të vetëqeverisjes vendore.

#### ❖ Privatizime

Institucioni i Prefektit të Qarkut ka ndjekur 1 (një) kërkesë për procedure privatizimi me shoqërinë në likuidim Petrol Alba SH.A.


Ndërkohe nuk ka pasur kërkesa për privatizim truall shtesë funksional dhe as kërkesa për konfirmim genplani që vijnë nga Dega e Shoqërive Publike.

#### ❖ Hartim projekti dhe preventivi për nevoja të institucionit

Është hartuar projekti dhe preventivi për rikonstruksion të zyrave të Arkivës së Gjëndjes Civile .

Është inspektuar në vend, është matur dhe është hartuar projekti i godinës së Nën-Prefekturës Lushnje

❖ Shqyrtimi i procesverbaleve të konstatimit të shkeljeve për leje drejtimi të lëshuara në shtete të huaja



Komisioni i shqyrtimit të lejeve të drejtimit për shkeljet e kryera nga drejtuesit e mjeteve që zotërojnë leje drejtimi të lëshuara në një shtet të huaj bazuar në Ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe Ligjin nr.8378 datë 22/07/1998 “Kodi Rrugori Republikës së Shqipërisë” kanë trajtuar në total

158 procesverbale të konstatimit të shkeljeve për leje drejtimi të leshuara në shtete te huaja.


❖ Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura

Janë mbajtur 2 mbledhje të Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura për Parkun Kombëtar Divjakë- Karavasta. Në këto mbledhje analizohet puna sistematike e projektit JICCA dhe janë trajtuar çështje të ndryshme që lidhen me:

Aktivite mjedisore	Menaxhimin e zones së mbrojtur
Ndotja e Ujrave	Sigurinë në zonën e mbrojtur
Peshkimi	Ruajtja e biodiversitetit

❖ Masterplani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane Qarku Fier

## QARKU FIER



Menaxhimi i Mbetjeve Urbane ka pas vëmendje të konsiderueshme gjatë vitit 2021. Ne fillim të vitit ka filluar nga puna testimi i Inceneratorit dhe Landfillit të Grumbullimit të Mbetjeve. dhe rreth muajt korrik ka filluar punë me kapacitet të plotë. Si institucion, kemi përmbushur rolin tonë duke nxitur njësitë e vetëqeverisjes vendore në mënyre të vazhdueshme deri në lidhjen e kontratave me Inceneratorin.

Edhe pse kosto e përpunimit të mbetjeve për 10 vitet e para për gjithë Njësitë e Qarkut Fier është *0 lek*, ky proces ka qenë paksa i vështirë për tu menaxhuar nga ana e tyre sepse kërkohen:

- *mjeteve logjistike për dërgimin e mbetjeve*
- *kostos shtesë për transport*
- *ndërtimi i pike presimi e transferimi*
- *lidhja e kontratës.*

Gjithsesi brenda vitit u arrit që të gjitha Njësite Vendore të Qarkut i depozitojnë mbetjet në Incenerator.

#### ❖ *Aksioni i Pastrimit të Qarkut Fier*

Me Urdhër të Prefektit Nr.49 datë 25.11.2021 është ngritur grupi i punës ndërinstitucional për marrjen e masave për pastrimin dhe higjienizimin e mjedisit nga mbetjet në qark dhe gjatë muajit Nëntor ka pasur një aksion masiv nga gjashtë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Janë ndjekur raportimet ditore, është përgatitur materiali hartografik me pikat e nxehta sipas planit të masave dhe bazuar ne aksion kombëtar “ SHQIPËRIA E PASTËR”.

#### ❖ *Pastrimi i hapësirave publike*

Përpos Aksionit të pastrimit që është ngritur në muajin Nëntor, Njësitë e Qeverisjes Vendore vazhdojnë pastrimin rutinë të hapësirave publike, parqeve dhe akseve rrugore dhe raportojnë në mënyrë periodike. Ditën e premte të çdo jave realizohet edhe pastrimi i kuletave në qytete dhe fshatra, që janë një masë parandaluese në rast të përmytjeve. Vlen të theksohet puna e tyre në eliminimin e vendgrumbullimeve të jashtëligjshme edhe pse ka ende punë për të bërë.

#### ❖ *Akset rrugore*

Sipas VKM Nr.600 datë 13.10.2021 “Për Pronësinë e Rrugëve Shtetërore dhe Kalimet e Pronësisë Ndërmjet Enteve Pronar të Rrugëve” ka ndryshuar matrica kilometrike e akseve rrugore që kalojnë në pronësi të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Për Qarkun Fier janë **21 akse rrugore** që ndryshojnë pronësi dhe në zbatim të kësaj VKM, në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë përmbledhur dhe përditësuar koordinatat dhe distancat kilometrike të akseve rrugore ndër qytetëse: nga qendrat e qyteteve

deri në pikë takimet e tyre me akset kombëtare për 24 akse rrugore

❖ Strehimi

<b>Bshkia Fier</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• 2 programe strehimi :<ul style="list-style-type: none"><li>- subvecion qeraje -34 F</li><li>-subvencion i kërkesave të kredisë 30 F</li></ul></li><li>• Publikim : thirrje për shfaqje interesi</li><li>• Ka filluar hartimin e një plani 5 vjecar strehimi</li></ul>	<b>Bashkia Lushnje</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• 2 programe strehimi :<ul style="list-style-type: none"><li>- subvecion qeraje -76 F</li></ul></li></ul>	<b>Bashkia Mallakastër</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Projekti : Përmirësim i kushteve të banimit për komunitetë të pafavorizuar</li><li>• Subvencion qeraje-18 F</li><li>• Probleme - kosto e ndëritmit e lartë</li></ul>
<b>Bshkia Patos</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• 2 programe strehimi :<ul style="list-style-type: none"><li>- subvecion qeraje -34 F</li><li>-subvencion i kërkesave të kredisë 30 F</li></ul></li><li>• Publikim : thirrje për shfaqje interesi</li><li>• ka filluar hartimin e një plani 5 vjecar strehimi</li></ul>	<b>Bashkia Divjakë</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• 1 program strehimi :<ul style="list-style-type: none"><li>- subvecion qeraje -12 F</li></ul></li></ul>	<b>Bashkia Roskovec</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• 2 programe strehimi :<ul style="list-style-type: none"><li>- banesa me kosto të ulët -3 F</li><li>-përmirësim i banesave ekzistuese deri në ndertimin e ri -44 F</li></ul></li><li>• ka filluar hartimin e një plani 5 vjecar strehimi</li></ul>

## V. MBROJTJA CIVILE

Veprimtaria e institucionit të Prefektit në drejtim të mbrojtjes civile është fokusuar në marrjen e masave për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë dhe përgjigjen për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë e tjera me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, të pronës, trashëgimisë kulturore si dhe mjedisit. Për këtë janë organizuar mbledhjet e KECQ "Për marrjen e masave për përballimin e situatave të mundshme të shkaktuara nga përmytjet". Janë hartuar dhe përditësuar: Plani i Përballimit të Emergjencave në nivel Qarku; Plani Evakuimit; Plani i Gatishmërisë me skenar për

përmbytjet; Plani i bashkëpunimit të strukturave monitoruese, vepruese dhe Operacionale dhe janë përditësuar pikat e kontaktit, mënyrat e marrjes së informacionit dhe shkëmbimin e ndërsjellët me të gjitha institucionet qendrore dhe lokale.

Janë përcaktuar dhe evidentuar burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe logjistike që disponon qarku dhe çdo drejtori në nivel qendror dhe lokal si dhe janë përcaktuar parashikimet e dëmeve të, janë përcaktuar kërkesat për mbështetje logjistike nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile.

I është kushtuar vëmendje ndjekjes konkretisht në terren të dinamikës së krijuar për shkak të emergjencave si dhe koordinimit dhe mbështetjes së strukturave, anëtare të KECCQ, për normalizimin e situatave të krijuara nga reshjet e shiut, dhe të emergjencave verore.

Vëmendja kryesore në fushën e emergjencave civile ka qenë evidentimi dhe ndjekja e masave parandaluese për emergjencat civile në nivel qarku dhe ndjekja e ritmikës së realizimit të tyre si dhe angazhimi i strukturave Operacionale nëpërmjet koordinimit të Prefektit në rastet e situatave emergjente të krijuara, kryesisht gjatë periudhës së verës.

Vlen të theksohet fakti i padiskutueshëm i vijimit të rolit dhe vëmendjes së treguar nga Qeveria Shqiptare në fushën e mbrojtjes civile, që me financimet e bëra ka mundur realizimin e një projekti të rëndësishëm për mbrojtjen e tokave bujqësore në qarkun Fier, si realizimi i investimit të Hidrovorit të ri të Divjakës që ka përmirësuar kullimin dhe parandalon përmbytjet sipërfaqësore të rreth 900 ha toke apo investimet e kryera nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit Fier nëpërmjet pastrimit të 96 km kanale të ujërave të larta ( KUL) dhe kulluese në bashkitë Fier, Lushnje, Divjakë dhe Patos.

Me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile, Qeveria Shqiptare pas inicimit dhe hartimit e ligjit të ri Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ka vijuar me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij, të cilat përmirësojnë dhe rregullojnë funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.

Gjatë vitit 2021 nga institucioni i Prefektit janë dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile ( AKMC ) dhe kanë gjetur mbështetje:

- 9 ( nëntë ) kërkesa për Forca Ushtarake.
- 2 ( dy ) kërkesa për ndërhyrje me helikopter nga ajri.
- 1 ( një ) kërkesë për mjete të rënd me zinxhirë ( fadrom).
- 1 ( një ) kërkesë për ndërtimin e një ure tip “Baily” në fshatin Darëzezë.

Gjithashtu, falë monitorimit, koordinimit të bërë nga institucioni i Prefektit gjatë muajve përvëlues të verës është rritur ndjeshëm **bashkëpunimi** i strukturave Operacionale në nivel vendor ( MZSH-të) duke i ardhur në ndihmë njëra – tjetrës për përballimin e situatave të shkaktuara nga zjarret, në veçanti strukturat e MZSH-së Patos dhe Roskovec në mbështetje të strukturave të bashkisë Fier.

**Konstatim:** Bashkitë, në rastet e situatave emergjente ( Kryesisht në situatat e zjarreve të mëdha ) nuk arrijnë të angazhojnë gjithë kapacitetet e deklaruara prej tyre.



Aktualisht, institucioni i Prefektit punon mbi Planin e Qarkut të Emergjencave Civile i miratuar në vitin 2017, pasi plani i ri që duhej miratuar brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit Nr. 45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile” nuk është miratuar ende për shkak edhe të mos miratimit të “Planit të Përgjithshëm Kombëtar”. Plani aktual i Emergjencave Civile në qark ( 2017), është përditësuar vazhdimisht në lidhje me çdo ndryshim të ndodhur në lidhje me funksionet, strukturë dhe pikave të kontaktit të qendrave apo personave që kanë rol në menaxhimin e situata emergjente.

**Konstatim:** Objektivi nuk është realizuar 100% për shkak edhe të pritjes së miratimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

#### **1. Detyra të tjera të realizuara:**

- Veprimtaria e TASK-FORCES “ Për luftën kundër kultivimit të Kanabisit”
- Përditësimi i dosjes me aktet ligjore dhe nënligjore.
- Rifreskimi i plan masave për sezonin pranverë – verë dhe vjeshtë – dimër.
- Krijimi i bazës së të dhënave mbi situatat e zjarreve.
- Koordinimi i forcave Operacionale në nivel qarku në situata emergjente.
- Hartimi dhe konceptimi i shkresave, informacioneve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore.
- Ndjekja e gatishmërisë teknike të hidrovoreve dhe furnizimi i tyre me energji elektrike me linjë të dyfishtë.
- të Kanabisit”
- 

#### **2. Emergjencat e ndodhura**

##### **2.1 Zjarre**

Gjatë vitit 2021, patëm 180 raste zjarri problematike, nga të cilat;

- Në objekte 47 raste, nga të cilat 46 objekte private dhe 1 rast në objekt publik.
- Në sipërfaqet e veshura me bimësi patëm 117 raste, nga të cilat 22 raste në pyje, 35 raste në ullishte dhe 60 në sipërfaqe të djerra private me shkurre, ferra e barishte.
- Në depozita bari të thatë për bagëti 6 raste.
- Në automjete 10 raste.

Në tabelën si më poshtë jepet shpërndarja e tyre e ndarë sipas bashkive dhe zërave të dëmtuar.

Emertimi NJ.V.Q.V	Raste Gjithsej	Objekte			Siperfaqet e veshura me bimesi						Depozita bari per blegtorinë	Automjete
		Rastet	Private	Publike	Rastet	Pyje		Ullishte		Sip.t ë dierr a		
						Rastet	Siperf. e Diegur (në ha)	Rastet	Sasia e Diegur (në rrënjë)			
Qarku Fier	180	47	46	1	117	22	257	35	15711	60	6	10
Bashkia Fier	72	21	20	1	42	12	150	10	11938	20	2	7
Bashkia Lushnje	36	13	13	0	21	0	0	7	940	14	1	1
Bashkia Mallakaster	27	4	4	0	22	7	100	5	590	10	0	1
Bashkia Patos	19	5	5	0	12	2	6	6	1895	4	2	0
Bashkia Divjake	7	2	2	0	5	1	1	3	80	1	0	0
Bashkia Roskovec	19	2	2	0	15	0	0	4	268	11	1	1

#### Konstatime:

- Infrastruktura rrugore në drejtim të pyjeve/maleve ka qenë jashtë funksioni apo ka munguar plotësisht.
- Strukturat e M.C së bashkive në shumë raste nuk realizuan do të angazhimin e strukturave të tjera të bashkisë të planëzuara prej tyre, në mbështetje të MZSH-së, për vënin nën kontroll të situatës para se zjarri të rriste përmasat e tij.
- Nuk funksionoi si duhet dhe çaloj organizimi i ruajtjes dhe kontrollit të sipërfaqeve të ekonomive pyjore vendore, në disa raste të tij.
- Mbetet problem sensibilizimi i duhur i fermerëve, si për rrezikun që mund të sjell dalja jashtë kontrollit e ndezjes dhe përdorimit të zjarreve për djegien e mbeturinave në parcelat e tyre, si dhe për dëmtimin strukturor dhe varfërimin e fuqisë prodhuese të tokës bujqësore.
- Repartet e MZSH-ve gjatë veprimeve reaguese, kanë patur mangësi të dukshme, si në sasi ashtu dhe në cilësi të kapaciteteve tekniko-njerëzore të tyre.

- Mungese të hidrantëve në ato zona pyjore në brendësi të cilave ndodhen depo të ujit të pijshëm.

## 2.2 Përmbytje.

Në muajin dhjetor të vitit 2021, si pasojë e reshje të dendura të shiut në të gjithë territorin e vendit, pati shtim të prurjeve në lumenjtë që përshkojnë qarkun Fier duke krijuar problematika kryesisht përgjatë rrjedhës së lumit Vjosa, si pasojë e daljes së tij nga shtrati u krijuan situata problematike me:

- 100 banesa me prezencë uji në fshatrat Çerven dhe Ferras.
- 16 familje të evakuara në Çerven dhe Ferras.
- 500-600 ha tokë bujqësore nën ujë.
- 

### Konstatime:

Përgjatë rrjedhës së lumenjëve në qarkun Fier, mungojnë pajisjet teknike/teknologjike për matjen e nivelit/prurjeve që do ndihmonte në situatat emergjente pozitivisht në realizimin sa me efikas të paralajmërimit të hershëm dhe njoftimit të komuniteteve të rrezikuara.

## VI. VEPRIMTARIA E TASK-FORCE “ PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”.

Gjatë vitit kaluar, veprimtaria e Task-Forcës Vendore (TFV) Fier “Për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit”, ishte në drejtimet si më poshtë;

- Analizimi dhe raporti vjetor i TFV Fier, për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, gjatë vitit paraardhës.
- Hartimi i planit vjetor 2021 , të veprimtarisë së TFV Fier.
- Hartimi i planit të monitorimit dhe ushtrimit të kontrolleve të territorit.
- Administrimi i planeve dhe informacioneve për këtë temë, nga strukturat anëtare të TFV-Fier.
- Hartimi i raporteve javore, mujore, 6-mujore dhe vjetore të TFV-Fier për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.
- 

Gjatë vitit 2021 patëm gjithsej si qark 42 raste me 6384 bimë të kultivimit të kanabisit, nga të cilat 15 raste pronë publike me 2794 rrënjë dhe 27 raste në pronë private me 3590 rrënjë.

Për këto raste janë arrestuar 54 persona.

Në tabelën si më poshtë jepet shpërndarja e tyre të ndara sipas juridiksionit territorial të përgjegjesisë.

Nr.R	TOTALI	Pronësia e Territorit		
------	--------	-----------------------	--	--

	Struktura Vendore			Publik		Objekt/toke privat		Total	Persona të arrestua
		Rastet	Numri Bimëve	Rast.	Numri bimëve	Rast.	Numri bimëve	Kg/ sekustr	
N 1	QARKU FIER	42	6384	15	2794	27	3590	153.73	54
2	BASHKIA FIER	27	3288	7	1635	20	1653	144.49	35
3	BASHKIA LUSHNJE	2	1581	-	-	2	1581	-	6
4	BASHKIA MALLAKASTËR	5	772	4	748	1	24	-	3
5	BASHKIA DIVJAKE	2	271	2	271	-	-	-	0
6	BASHKIA PATOS	2	130	-	-	2	130	7	6
7	BASHKIA ROSKOVEC	4	342	2	140	2	202	2.245	4

## 6.1 PROBLEMATIKA

### a. Në fushën e emergjencave civile

- Në pjesën më të madhe të rasteve të zjarreve, sidomos në sipërfaqet me ekonomi pyjore, **kemi të bëjmë me veprimtari të pastër kriminale, me qëllime dhe interesa te caktuara.**
- Zbulueshmëria dhe vënia përpara përgjegjësisë ligjore personave zjarrvënës ka qenë e ulët. Strukturat Vendore të Policisë, duhet të rrisin bashkëpunimin me strukturat e bashkive, për emergjencat në tërësi e tyre dhe ne veçanti për parandalimin e zjarreve.
- Është i domosdoshëm hartimi dhe nxjerrja e një akti ligjor, për ndalimin e ndezjes dhe përdorimit të zjarreve në sipërfaqet e veshura me bimësi dhe objektet me rrisht të lartë zjarri, gjatë muajve të verës..
- Bashkitë duhet të marrin përsipër përgjegjësitë dhe të përmbushin detyrat e tyre ligjore, në kontrollin e territorit që kanë në juridiksionin e tyre, si dhe të rrisin dhe përmirësojnë kapacitetet reaguese, teknike dhe njerëzore të strukturave të M.C dhe MZSH-ve.
- Bashkitë gjatë vitit 2021 në fushën e mbrojtjes civile kanë kryer shumë pak ose aspak investime në fushën e mbrojtjes civile.

## VII. TASK FORCA, KOMITETET RAJONALE SI DHE ORGANI KËSHILLUES PRANË PREFEKTIT TË QARKUT

Në kuadër të detyrave të lëna nga Komiteti Rajonal I Turizmit dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.55 date 24.06.2021 “Për ngritjen e Task Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2021” është bashkëpunuar, koordinuar, dhe monitoruar nga Institucionet shtetërore dhe NJVQV-te në Qark në këto drejtime:

- Detyra të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të përcaktuara të Urdhërimit të Kryeministrit Nr.55 Datë 24/06/2021 “Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2021” të lidhura me Institucione të tjera:
- Zbatimin e planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2021.
- Hartimin dhe zbatimin e planit për evidentimin dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe mbetje të tjera me impakt negativ në mjedis, gjatë rrugëve nacionale dhe atyre që të çojnë në destinacionet turistike.
- Hartimin dhe miratimin me Vendim të Këshillit Bashkiak nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, planet lokale të zhurmave. Zbatimi i programit të kontrollit, për monitorimin e ndotjes akustike në destinacionet turistike.
- Organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive argëtuese në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, shoqata, institucione qendrore dhe lokale, publike dhe private etj. Për vitin 2021, çdo aktivitet argëtues i lejuar në përputhje me rekomandimet dhe urdhrat e MSHMS.
- Verifikimi i masave të sigurisë së pushuesve ( rojet e plazhit, vendosja e sinjalistikës, bovat etj)
- Bashkëpunimin me MTM për përcaktimin e zonave për ankorimin e mjeteve lundruese argëtuese, korridoret e hyrje daljeve dhe përgatitja e hartës përkatëse për plazhet në zbatim të VKM Nr.321 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”. Pajisja e korridoreve të hyrje daljeve të mjeteve lundruese argëtuese me sinjalistikën përkatëse.
- Angazhimi i FARSH, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile gjatë sezonit turistik.
- Inspektime dhe kontrolle për respektimin e normave higjieno-sanitare në objektet turistike, restorante e struktura akomoduese.
- Dezinfektimin e zonave bregdetare, ligatinore dhe qyteteve bregdetare, përpara fillimit të sezonit veror. (MSHMS) Kontributi në fushatat dhe aksionet e pastrimit të zonave turistike.
- Masat e marra për furnizimin pa ndërprerje me ujë si dhe sistemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, veçanërisht në destinacionet turistike.

Përgatitjen e planit te koordinimit për ta patur nën kontroll situatën për çdo defekt të mundshëm gjatë gjithë sezonit turistik.

- Përcaktimin e vend-depozitimeve të inerteve dhe mbetjeve urbane të ngurta.

Detyra te drejtpërdrejta për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktuara e Urdhërin e Kryeministrit Nr.55 Datë 24/06/2021 “Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik veror 2021”

- Bashkëpunimin me MMT për realizimin e zhvillimit te stacioneve te plazhit me standarde sipas destinacionit dhe tipologjive.
- Sigurimin e sinjalistikës se nevojshme ne plazhe (rëre dhe ujë) për saktësimin e plazheve private dhe publike si dhe zonat ujore te lejuara dhe ato me rrezikshmëri.
- Marrjen e masave për mirëmbajtjen e rrugëve te brendshme( vijëzimi i rrugëve, vendosja e sinjalistikës dhe informacion ne lidhje shërbimet bazë: polici, spitale, plazhe, pika te vizitueshme) rrugëve që të çojnë drejt destinacioneve turistike dhe ndriçimin e tyre.
- Zbatimin e planit të integruar të mbetjeve, planet për vendosjen e kontejnerëve dhe të zhvendosjes së mbetjeve urbane në të gjithë destinacionet turistike.
- Përcaktimin e vend parkimit te automjeteve në zonat e plazheve.
- Hapjen dhe vënien ne funksion të zyrave të informimit për turistët në qendrat e qyteteve dhe në afërsi te pikave turistike.
- Vënien në dispozicion të pushuesve numra telefoni pranë NJVQV-ve për ankesa apo shërbimet e munguara.

➤ **Nga ana e Inspektoratit Shtetëror është kryer Inspektim për sezonin turistik veror 2021 I cili konstaton se:**

○ Subjekte të inspektuara:

- 17 subjekte akomoduese, Hoteleri - ku janë marrë masa paralajmërim në 2 subjekte për mungesë të dokumentacionit Akt Miratim Higjiene Sanitar.
- 74 vepra ujësjellësi (puse, depo të furnizimit me ujë të popullatës) – ku janë vendosur 17 masa këshillime për problematikat e konstatuara lidhur me rrethimin e këtyre objekteve, mbrojtjen e zonave sanitare, kushte jo konform standardeve etj.
- 146 inspektime në shërbimet kozmetike (Parukeri, berber, qendra estetike, shërbime kozmetike) – ku janë marrë 82 paralajmërime, masa të vendosura kryesisht për mungesë të dokumentacionit shëndetësor (libreza shëndetësore, raporte mjeko ligjore,

certifikatë të kryerjes së shërbimit të dezinfektimit) dhe mungesë të dokumentacionit Akt Miratim Higjieno Sanitar.

- 1 pishine
- 2 subjekte social kulturore: Parku Arkeologjik Apolonia dhe Muzeu Fier – është konstatuar se në Muzeun e Fierit ka disa ambiente me lagështi që kanë nevojë për ndërhyrje. Është lënë detyre me paralajmërim për marrjen e masave.

➤ **Nga ana e Drejtorisë Rajonale të policisë Fier për sezonin turistik veror 2021 u morën këto masa.**

Sezoni Turistik veror 2021 nga ana e shërbimeve policore të D.V.P Fier është përballuar me sukses, duke patur parasysh ngarkesën dinamike që ky sezon ofroi për flukset e mjeteve dhe pushuesve si të huaj ashtu dhe vendas të cilat kanë përshkruar territorin e Qarkut Fier .

- D.V.P Fier si pjesë e Task-Forcës së ngritur në kuadër të masave të caktuara nga Urdhëri Nr.55 i K.M datë 24.06.2021 “Për ngritjen e Task –Forcës ndër Institucionale të sezonit turistik veror është angazhuar në mënyrë serioze dhe profesionale për pjesëmarrjen në ç’do takim të kryer nga Institucioni i Prefektit dhe ka zbatuar detyrat e vendosura në Planet e Masave të hartuara “Për garantimin e rendit dhe sigurisë publike para gjatë dhe pas sezonit turistik veror 2021” .Duke analizuar dinamiken e detyrave të kryera si dhe ngarkesën e forcave policore kemi hasur vështirësi në realizimin e detyrave në këto drejtime :
- Problematikë shqetësuese që kërkon ndërhyrje për zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjate është koha e hartimit të kontratave për Subjektet që përdorin rërën në vijën bregdetare, kontrata të cilat kanë përfshirjen e disa Institucioneve .Në tërësinë e tyre kontratat e subjekteve arrijnë të përfundohen të firmosura në fundin e muajit Korrik apo fillim i muajit Gusht duke sjelle shumë problematika paqartësi konfuzion, hallakatje dhe mos marrje përgjegjësie nga ana institucionale.
- Mendojmë që koha e hartimit të kontratave duhet të ketë përfunduar brenda Muajit Maj afat i cili ju le kohë bizneseve për marrje masash si dhe institucioneve shtetërore që monitorojnë dhe kontrollojnë zbatimin e tyre si dhe duhet zgjatur afti i dhënies së kontratës **të paktën me 3 vjet.**
- Nuk kemi rakordim veprimesh ndërinstitutionale midis Bashkive dhe Agjencisë Kombëtare të Turizmit .Bashkitë si Administruese të territorit për vijën bregdetare dhe përfituese të drejtpërdrejta të ardhurave financiare që vijnë nga sezoni turistik nuk angazhohen të bashkëpunojnë me subjektet private të interesuara për kontratat .Policia Bashkiake pranë Bashkive është inegzistetente dhe nuk merr përgjegjësitë e duhura në terren për administrimin e tyre .Vija bregdetare e cila ju jepet në përdorim subjekteve private nuk pastrohet në kohën e duhur nga mbeturinat dhe nuk ka organizim për pastrimin e mbetjeve për dhënien e një imazhi

pozitiv ndaj kujtdo që viziton këto ambiente , turistëve dhe vizitorëve si vendas ashtu dhe të huaj .

- Sinjalistika rrugore në akset që të çojnë drejt plazheve Seman , Darëzezë ,Pishë-Poro Levan dhe Divjakë lë shumë për të dëshiruar ka mungesa të shumta dhe nga ana e Bashkive nuk investohet për vendosjen e tyre pavarësisht kërkesave të herëpashershme nga ana e Sektorit të Policisë Rrugore në D.V.P. Fier.
- Lidhur me hapësirat e plazheve publike ku Bashkitë kanë detyrimin për ngritjen e kullave të vrojtimit si dhe vendosjen e shërbimit të rojeve bregdetare kemi hasur vështirësi pasi në asnjë rast Bashkitë nuk kanë personel me argumentin se nuk kanë të buxhet financiar për të përballuar shpenzimet në lidhje me trajnimin e tyre . Ky shërbim është tejet i rëndësishëm në vijën bregdetare pasi rastet e rrezikimit të jetës së pushuesve kanë qenë evidente në të gjitha plazhet.
- 

### **Task Forca Vendore “Për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit”**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, bazuar në Planin Kombëtar të Ministrisë së Brendshme “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike gjatë vitit 2021”, pranë këtij institucioni me urdhër të Prefektit të Qarkut është ngritur Taks forca vendore e Luftës Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit. Institucioni i Prefektit të qarkut ka raportuar çdo javë në Ministrinë e Brendshme për veprimtarinë e Task Forcës Vendore

Gjatë vitit kaluar, veprimtaria e Task-Forcës Vendore (TFV) Fier “Për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit”, ishte në drejtimet si më poshtë;

- Analizimi dhe raporti vjetor i TFV Fier, për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, gjatë vitit paraardhës.
- Hartimi i planit vjetor 2021 , të veprimtarisë së TFV Fier.
- Hartimi i planit të monitorimit dhe ushtrimit të kontrolleve të territorit.
- Administrimi i planeve dhe informacioneve për këtë temë, nga strukturat anëtare të TFV-Fier.
- Hartimi i raporteve javore, mujore, 6-mujore dhe vjetore të TFV-Fier për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Gjatë vitit 2021 patëm gjithsej si qark 42 raste me 6384 bimë të kultivimit të kanabisit, nga të cilat 15 raste pronë publike me 2794 rrënjë dhe 27 raste në pronë private me 3590 rrënjë.

Për këto raste janë arrestuar 54 persona.

Në tabelën si më poshtë jepet shpërndarja e tyre të ndara sipas juridiksionit territorial të përgjegjësisë.



Nr.R	Struktura Vendore	TOTALI		Pronësia e Territorit				Total	Persona të arrestua
				Publik		Objekt/toke privat			
		Rastet	Numri Bimëve	Rast.	Numri bimëve	Rast.	Numri bimëve	Kg/ sekustr	
N 1	QARKU FIER	42	6384	15	2794	27	3590	153.73	54
2	BASHKIA FIER	27	3288	7	1635	20	1653	144.49	35
3	BASHKIA LUSHNJE	2	1581	-	-	2	1581	-	6
4	BASHKIA MALLAKASTËR	5	772	4	748	1	24	-	3
5	BASHKIA DIVJAKE	2	271	2	271	-	-	-	0
6	BASHKIA PATOS	2	130	-	-	2	130	7	6
7	BASHKIA ROSKOVEC	4	342	2	140	2	202	2.245	4

Në mbështetje të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 9 pika 1 dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr.6, pika 5 &2, datë 27.01.2017 “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikimit të Personave në çdo Qark, Bazuar në Strategjinë kundër krimit të organizuar e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit 2018 – 2020, pranë këtij institucioni është ngritur Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për Qarkun e Fierit. Ky komitet ka zhvilluar rregullisht dhe në mënyrë periodike mbledhjet e tij si dhe ato të Tryezës Teknike Rajonale.

Institucioni i Prefektit Qarku Fier ka zhvilluar aktivitete në godinën e Institucionit të Prefektit, dhe ka marrë pjesë aktive në takime dhe marshime të zhvilluara nga NJVQV-te dhe Institucione të tjera me teme dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

- Muaji Tetor, është cilësuar si “Muaji Antitrafik”.
- Datat 25 Nëntor deri më 10 Dhjetor janë cilësuar si “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore”

Disa nga faktorët e shtimit të dhunës, sidomos dhunës në familje janë:

- Mentaliteti lidhur me njohjen dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës, fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike.
- Dhunues që kanë varësi nga konsumimi i alkoolit dhe lëndëve narkotike
- Mungesa e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese për të dhunuarit dhe dhunuesit

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2021, nga KRAT Fier janë marrë të gjitha masat tekniko-organizative, operative dhe procedurale për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e personave apo grup personave, që tentojnë të kryejnë trafikimin e qenieve njerëzore brenda dhe jashtë vendit.

KRAT Fier ka zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese me shkolla dhe mjedise publike, në të gjithë territorin e bashkive të qarkut

Këto aktivitete janë kryer në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet DRAP, Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorisë Vendore të Policisë, strukturave pranë bashkive dhe aktoreve të tjerë. Aktivitetet kanë qenë të paracaktuara ose sipas rastit dhe problematikave të hasura.

Aktivitetet janë fokusuar në:

- Trajnime që kanë si qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve mbi mënyrat dhe format e ndryshme të trafikimit.
- Fokus-grupe me përfshirjen e të gjithë nxënësve për të diskutuar format dhe mënyrat e ndryshme që mund të përdoren nga trafikuesit. Këto fokus grupe nxitën te nxënësit qasjen pozitive ndaj këtij fenomeni.
- Përfshirja e drejtpërdrejtë e nxënësve në diskutime për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore përmes rritjes së ndërgjegjësimin për rreziqet dhe pasojat negative që shkakton trafikimi jo vetëm te individit por në të gjithë shoqërinë. Kjo është realizuar nëpërmjet: ekspozitave me punime të nxënësve në pikturë, postera dhe mesazhe mbi këtë temë; takime me senatet ku janë marrë mendime rreth masave të ndërhyrjes në shkollë.
- Seanca informuese te nxënësit nëpërmjet dhënies së informacionit parandalues, duke ndërtuar ndërhyrje më të targetuara për të rinjtë në rrezik në shkollë (si p.sh. nxënësit me performancë të ulët, me probleme sociale, braktisje shkolle, probleme familjare (prindër të divorcuar, probleme financiare, sociale etj - kryesisht nëpërmjet psikologeve/punonjësve social në shkollë), shtresa te marginalizuara (të ardhur, familje rome), mikrokomunitete te prirur ndaj party, individë që kanë fituar një pavarësi financiare relative, etj). Nxënësit janë njohur me mënyrën se si shkolla, mësuesit, prindërit dhe vetë nxënësit duhet të reagojnë kur kanë një indikacion rreth trafikimit të një individit.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier nuk ka trajtuar raste të viktimave të trafikimit/të mundshme të trafikimit bazuar mbi Procedurat Standarde të Veprimit mbi 18 vjeç për periudhën Janar –Dhjetor 2021. Nga ana e punonjësve social është trajtuar vetëm rasti i një vajze e cilësuar si VMT e cila pas një viti trajtimi në “Qëndren Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Trafikimit Lizë” është rikthyer në familje në muajin dhjetor 2021. DRSHSSH Fier monitoron rastin në vazhdimësi ashtu si edhe institucionet e tjere të përcaktuara në ligj.

Në kuadër të muajit anti trafik, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier në bashkëpunim me NJMF-të të bashkive Patos dhe Mallakastër kanë organizuar takime sensibilizuese me nxënës dhe mësues të shkollave 9-vjecare dhe të mesme duke shpërndarë informacion të vlefshëm për ta në lidhje me trafikimin e qenieve njënieve dhe migracionin e

parregulltë. Janë organizuar rreth 5 takime kjo për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 dhe masave të marra për organizim aktivitetesh.

Më poshtë po ju citojmë disa aktivitete të zhvilluara.

### **Drejtoria Vendore E Policisë Fier**

Gjatë vitit 2021 nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, janë evidentuar 3 raste për veprën penale “Trafikim i personave të rritur” neni 110/a dhe 2 raste për veprën penale “Trafikim i të miturve” neni 128/b për të cilën janë kryer veprimet procedurale dhe janë referuar materialet përkatësisht në Prokuroritë Fier dhe Lushnje për veprime të mëtejshme.

Për dhunën në familje përgjatë vitit 2021 në juridiksionin e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, janë evidentuar:

- 396 Raste janë Kërkesë Padi për Urdhër Mbrojtje dërguar Gjykatës.
- 142 Raste për “Dhunë në Familje”, neni 130 /a i Kodit Penal
- 4 Raste “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” neni 79/c i Kodit Penal.
- 1 Rast “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” e mbetur në tentative, nenet 79/c dhe 22 të Kodit Penal.
- 20 Raste “Veprime në kundërshtim me vendimin e Gjykatës” neni 321 i Kodit Penal

### **Bashkia Fier**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, janë zhvilluar aktivitete informuese me nxënës të shkollave të qytetit me tematika të ndryshme sociale, ndër të cilat edhe trafikimi i qenieve njerëzore.

Gjithashtu gjatë muajit Tetor, i cilësuar si muaji AntiTrafik janë zhvilluar sesione informimi specifike mbi temën e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe migracionit të parregullt.

Këto aktivitete janë zhvilluar në bashkëpunim, Zyrën Vendore të Arsimit, Parauniversitar dhe Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier.

Aktivitetet kanë qenë të pakta për shkak të masave të caktuara për mbrojtjen e komunitetit nga Covid-19.

*Përsa i përket të miturve të pashoqëruar që kanë dalë jashtë territorit të Shqipërise, për vitin 2021 nuk ka pasur asnjë rast*

### **Bashkia Lushnjë**

Per vitin 2021 janë dhënë 84 Urdhëra Mbrojtje të cilat janë pranuar nga gjykata si kërkesë padi për dhunën në familje dhe 17 Urdhëra Mbrojtje të cilat i është rrëzuar padia .

Të gjitha rastet janë monitoruar dhe në vazhdimësi duke bërë vizita familjare në mënyrë periodike në familjen e viktimës së dhunës, duke ofruar kështu dhe mbështetje psiko emocionale për të gjithë anëtarët e familjes. Gjatë vitit shkollor organizohen seminare me tema sensibilizuese, ndër to dhe janë trajtuar tema për barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Këto trajnime janë bërë në bashkëpunim me Ojfnë “ Partnere per femijet”.

### **Bashkia Divjakë**

MKR Divjakë ka trajtuar gjithsej 62 raste për vitin 2021. Këto janë raste të dhunës në familje, ndërkohë që nuk ka pasur raste të trafikimit të qenieve njerëzore.

Bashkia Divjakë, ka prodhuar fletëpalosje informuese dhe i ka shpërndarë ato në shkolla apo takimet e zhvilluara në komunitet, si dhe ka organizuar aktivitete ndërgjegjësuere me grupe të ndryshme të grave, të rejave, vajzave e djemve, etj. Një pjesë e mirë e këtyre aktiviteteve janë organizuar gjatë fushatave të përvitshme të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore (25nëntor – 10 dhjetor). Koordinimi i fushatave dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere që synojnë reduktimin e stereotipeve gjinore dhe praktikave diskriminuese për grupe të grave që pësojnë diskriminim të shumëfishtë, është bërë në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe psikologët e shkollave, si dhe me antarë të tjerë të MKR, përfshirë këtu edhe Prokurorinë e Policinë, të cilat janë angazhuar dhe kanë dhënë kontribut në këto aktivitete.

### **Drejtoria Rajonale E Ofrimit Te Formimit Profesional Publik Fier**

Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Fier gjatë vitit 2021 ka qënë pjesë aktive e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe tryezës teknike Antitrafik të ngritur pranë Prefektit Fier, duke dhënë kontributin dhe përvojën e saj, si në drejtim të sensibilizimit të personave për luftën kundër trafikimit me qëllim parandalimin e këtij fenomeni dhe identifikimit të rasteve të personave të trafikuar në institucionin tonë dhe vetëm për t'i ardhur në ndihmë kësaj shtrese vunerabël të shoqërisë.

### **Bashkia Patos**

Gjatë vitit 2021 nga Bashkia Patos janë trajtuar 22 raste të dhunës në familje, prej të cilave 16 të gjinisë femërore dhe 6 të gjinisë mashkullore. Të gjitha rastet janë referuar nga Stacioni i Policisë Patos dhe janë trajtuar në bashkëpunim me institucione në nivel vendor dhe rajonal. Përsa i përket rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, nuk kemi pasur asnjë rast.

### **Bashkia Mallakastër**

Numri i rasteve për Dhunën në Familje dhe Trafikimin e Qënieve Njerzore për vitin 2021  
Dhuna në familje; Raste gjithsej 22

Nga këto;Femra:17,(shtatëmbëdhjetë), Meshkuj:5 (pesë)

- Referuar nga Shërbimi Social 9(nentë) raste.
- Referuar nga Policia 13 raste (trembëdhjetë) raste
- 22 ( Njëzetë e dy) viktima të dhunës në familje,janë pajisur me Urdhër Mbrojtje nga Gjykata
- Këto viktima të dhunës (22) janë trajtuar me ndihmë ekonomike sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Strukturat e KRAT Fier janë të angazhuara në luftën kundër trafikimit të qenieve njerzore, për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, për të gjitha format e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar, duke kryer në çdo rast veprimet e procedurale dhe duke vënë përpara përgjegjësisë ligjore autorët.

Si pjesë e përmbushjes së detyrimeve tona ligjore, edhe pse në kushtet e Covid-19 vazhdon puna për parandalimin, evidentimin dhe luftimin e këtij fenomeni duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave .

#### **Ndjekja e situatës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19 në Qark.**

Institucioni i Prefektit e ka përqendruar punën në monitorimin dhe marrjen e masave për zbatimin e detyrave të dala nga aktet ligjore e nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.15/2016 “ Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” dhe akteve nënligjore të nxjerra për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe në monitorimin e ecurisë së ndikimit të infeksionit COVID-19 në Institucionet e Administratës publike. Raportimi merret nga NJVKSH Fier, Lushnjë dhe Mallakastër çdo dite dhe çdo javë për të gjitha qendrat shëndetësore ne lidhje me:

- Numrin e personave aktiv me COVID-19, të kategorizuar në mësues, edukatorë, personel mbështetës, pedagog, nxënës, fëmijë kopshti, student, personel shëndetësor, etj, me shpërndarje sipas Bashkive,
- Numrin e personave me mjekim ambulator,
- Numrin e personave në regjim spitalor,
- Numrin e mostrave të marra,
- Llojin e mostrave (TSH, PCR)

Nga ana e Institucionit të Prefektit kryhet raportim pranë Zyrës Operacionale të situatës sipas tabelës:

Nr.	Veprimtaria	Drejtuar
1.	Raportim ditor Covid 19	ZOS
2.	Raportim Javor Covid 19	ZOS
3.	Raportim ditor dhe javor nga Drejtoria Arsimore deri në muajin Qershor 2021,	Min. Brendshme ZOS
4.	Raportim ditor për inspektimet dhe monitorimet e kryera nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor deri me 15.07. 2021	Min. Brendshme

➤ **Vërtetimi I dokumentacionit të lëshuar për përdorim jashtë Vendit.**

NJVQ depozitojnë në Institucionin e Prefektit, specimentet e nënshkrimit dhe vulën zyrtare të punonjësve të gjendjes civile në juridiksion të tyre si dhe të titullarit të NJVQV apo të personit/personave që u delegohet e drejta për të firmosur dokumente të cilat do të përdoren nga shtetasit shqiptar për jashtë shtetit. Për vitin 2021 janë vërtetuar nga Sektori I MKV dhe FD gjithsej **43 941** copë.

## 6. Struktura organike e Administratës së Prefektit Qarku Fier.

Për administratën e Prefektit të Qarkut, për vitin 2021, plani i strukturës organike, nuk ka ndryshuar, nga ajo e vitit 2016.

Është në fuqi struktura e ardhur, me urdhër të Kryeministrit nr. 4 datë 12.01.2016, e ndërtuar në Sektorë dhe ka një organike prej 29 punonjësish.

Si funksion i deleguar janë vetëm arkivat e gjendjes civile në Fier dhe dy nënprefekturat me 3 punonjës gjithsej.


Theksojmë se:

Duhet të merret parasysh, nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, akordimi i fondeve për shpenzime operative për gjendjen civile, si funksion i deleguar.

Struktura e Administratës së Prefektit të Qarkut, është si më poshtë vijon:

I

Struktura organike e Institucionit të Prefektit Qarku Fier, si u theksua dhe më lart, ka ndikuar edhe në funksionimin jo të mirë, dhe mosrealizimin e objektivave të institucionit, në mosrealizimin e buxhetit, për arsye të mbetjes së vendeve vakante për një kohë të gjatë. Gjatë vitit 2021, kanë qenë 5 vende vakante, për nëpunësin civil.



Kërkojmë:

Më shumë bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe me Departamentin e Administratës Publike, për plotësimin e vendeve të mbetura vakante, dhe pozicionimin sipas strukturës, dhe kriterëve që i përshtaten pozicioneve të punës, sipas sektorëve, pasi janë sjelle në pune, punonjës jo sipas kriterëve që duhen për pozicionet përkatëse.

Mosmiratimi i strukturës së re, të propozuar nga Prefektët e Qarqeve, nga Ministria e Brendshme dhe Qeveria, sjell një dobësim të autoritetit të institucionit të Prefektit, për ushtrimin e funksioneve të tij, ndaj njësive vendore, dhe ndaj prioriteteve të politikës qeveritare.

Më konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

**6.1 Personeli, Janar-Dhjetor 2021.**

NR	PËRSHKRIMI I PERSONELIT	Janar 2021			Dhjetor 2021		
		PLAN	FAKT	VAKANT	PLAN	FAKT	VAKANT
<b>1</b>	<i>Nr. i pozicioneve sipas strukturës së miratuar.</i>	32	26	6	32	27	5
<b>Nga të cilët:</b>							
<b>2</b>	<i>Nr. i pozicioneve të funksionarëve politik sipas strukturës</i>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>3</b>	<i>Nr. i nëpunësve civilë</i>	<b>23</b>	<b>18</b>	<b>5</b>	<b>23</b>	<b>19</b>	<b>4</b>
<b>4</b>	<i>Nr. i punonjësve mbështetës.</i>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<i>Nr. i punonjësve për funksionet e deleguara.</i>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>0</b>

**Emëruar nga procedura e lëvizjes paralele:** 3 nëpunës civil.

**Larguar nga procedura e lëvizjes paralele:** 2 nëpunës civil.

**Emëruar nga procedura e pranimit në shërbim civil:** 3 nëpunës civil në periudhë prove.



**Emërim nga VKM për punësimin e ekselentëve:** 1 nëpunës.

**Emërim në detyrë:** 1 funksionar politik.

**Emërim:** 1 punonjës mbështetës.

**Dorëheqje:** 1 nëpunës civil & 1 funksionar politik.

**Lirim nga detyra:** 1 funksionar politik.

**Fituan statusin e nëpunësit civil:** 6 nëpunës.

Prioritet i punës, për vitin 2022, mbetet plotësimi i vendeve vakante, sipas aftësive profesionale, dhe kritereve të përcaktuara, në aktet ligjore, nënligjore, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Brendshme, dhe plotësimi vazhdimisht i ndryshimeve në regjistrin elektronik të punonjësve (HRMIS).

## VIII. REKOMANDIME

Përmirësimi i mëtejshëm i punës dhe performancës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier kërkon përkushtim dhe angazhim gjatë këtij vitit nga administrata e Prefektit . Për realizimin e kësaj performance dua të rendit disa rekomandime, si më poshtë:

- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile si dhe me shoqata mjedisore për krijimin e një mjedisi të pastër brenda territorit të qarkut.
- Respektimin e afateve kohore në raportimin periodik mujor të Degëve Territoriale, dhe pasqyrim të arritjeve sipas objektivave të vendosura mujore prej tyre si dhe problematikave
- Përgatitja e planeve vjetore në përputhje me ligjin për Çdo Degë Territoriale dhe dërgimi i tyre pranë institucionit të Prefektit brenda muajit shkurt 2022
- Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve duke shërbyer me profesionalizëm dhe me integritet moral si dhe shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjidhjes ligjore brenda afateve kohore.
- Rritja e performancës së punonjësve të administratës shtetërore brenda çdo institucioni apo degë territoriale.
- Rritja e rolit të Prefektit në konsolidimin e imazhit të institucionit nëpërmjet menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.
- Rritja e bashkëpunimit në Institucionin e Prefektit të Qarkut në mbështetje të personelit për përmirësimin e kushteve të punës si në aspektin jetësor ashtu edhe atë funksional sipas sektorëve dhe në tërësi për Institucionin e Prefektit.
- Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrit, shkresës, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtja e dokumenteve shkresore, monitorimi i ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite
- Rritja e bashkëpunimit midis Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, Inspektorateve Shtetërore, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut me qëllim parandalimin dhe identifikimin e autorëve në veprat penale si zjarrvënje e qëllimshme, kultivimi i lëndëve narkotike, prerja e pyjeve, etj.

- Hartimi i Planit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në shkallë qarku, bazuar në ndryshimet ligjore e udhëzimet e ardhura nga AKMC, duke i kushtuar rëndësi të veçantë analizës së riskut, llogaritjes së forcave dhe mjeteve (të strukturave vendore, strukturave qendrore dhe të tretëve) dhe skenarëve të ndryshëm sipas probabilitetit të ndodhjes.

## **IX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022**

### **1. Forcimi i rolit të Prefektit të Qarkut në marrëdhënie me NJVQV-te gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative.**

#### **Ky objektivi do të vihet në zbatim nëpërmjet:**

- Verifikimit ligjor të akteve me karakter normativ nga ana e sektorit juridik në bashkëpunim me sektorët përkatës sipas natyrës së aktit normativ.
- Kryerjes së verifikimit në vend të akteve me karakter normativ në mënyrë efektive dhe periodike duke garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi përsa i përket verifikimit ligjor të akteve.
- Zhvillimit të takimeve konsultative me kryetarët dhe sekretarët e këshillave bashkiak.

### **2. Rritja e performancës juridike të administratës së Prefektit të Qarkut në koherencë me ndryshimet e kuadrit ligjor**

#### **Ky objektivi do të vihet në zbatim nëpërmjet:**

- Bashkëpunimit dhe ofrimit të asistencës juridike sektorëve për azhurnimet e kuadrit ligjor.

### **3. Plotësimi i vendeve vakante, sipas aftësive profesionale, dhe kritereve të përcaktuara, në aktet ligjore, nënligjore, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Brendshme.**

#### **Ky objektivi do të vihet në zbatim nëpërmjet:**

-Bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme dhe me Departamentin e Administratës Publike, për plotësimin e vendeve të mbetura vakante, dhe pozicionimin sipas strukturës, dhe kritereve që i përshtaten pozicioneve të punës, sipas sektorëve,

### **4. Rritja e bashkëpunimit dhe ndërtimi i marrëdhënieve me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me qëllim njohjen dhe ushtrimin e kompetencave nga ana e tyre dhe evidentimin e problemeve për të cilat janë të interesuara NJVQV-të në raport me Organet e Qeverisjes Qendrore.**

#### **Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet:**

- Ofrimit të ndihmës dhe asistencës në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Institucionit të Prefektit, organeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për realizimin e kompetencave funksionale të tyre, me qëllim shtrirjen dhe zbatimin e programit qeverisës në nivel vendor, zbatimi e strategjive kombëtare dhe rajonale të miratuara, përbushjen e parimit të

decentralizimit si një proces i cili synon të përmirësojë efektivitetin e administratës publike dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

- Zhvillimi I marrëdhënieve, midis Institucioneve të pavarura dhe Institucioneve të varësisë në Qark si dhe Institucioneve qendrore të qeverisë , Ministrinë, KM, etj me qëllim koordinimin e tyre për realizimin e objektivave qeveritare dhe strategjive të miratuara në drejtim të funksioneve në fushën e sigurisë publike, fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e bujqësisë, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese etj, si dhe në drejtim të kompetencave të deleguara pranë pushtetit vendor duke adresuar çdo pengesë dhe problematikë në zbatimin e detyrave.**

**Do të realizohet nëpërmjet:**

- krijimit të mundësive për një bashkëpunim më të mirë dhe më të frytshëm ndërmjet Institucioneve në nivel horizontal dhe vertikal në mënyrë që problematikën të zgjidhen dhe të mos krijohen mbivendosje kompetencash, mosmbulim të funksioneve të sipërpërmendura apo mos koordinim të tyre. Mbulimi i detyrave dhe kompetencave nga çdo organ publik kërkohet të jetë harmonik në mënyrë që atje ku mbarojnë kompetencat e një organi fillojnë kompetencat e organit tjetër, kështu çdo problematikë e hasur në ushtrimin funksioneve dhe kompetencave nuk ngel pezull por zgjidhet nga Institucioni i Prefektit ashtu siç e përcakton edhe pika 3 neni 19 i Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

- Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve qendrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca te veçanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave te Komitetit Rajonal te Turizmit. Ndjekja e problemeve te sigurisë, të higjienës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.**

**Do të realizohet nëpërmjet:**

-realizimit me sukses te veprimtarive të Institucioneve të përfshira si NJVQV-të, ARRSH, DRTRR, ISHSH, NJVKSh, etj në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për një sezon te suksesshëm turistik në Qark si dhe turizmin në përgjithësi gjatë vitit.

- Ndjekja e veprimtarisë së organeve vendimmarrëse të NJVQV-ve, akteve normative të nxjerra prej tyre, nivelin juridik dhe funksional, nivelin e komunikimit me publikun dhe transparencën. Koordinimi i punës ndërmjet Institucioneve rajonale për zhvillimin e konsultimeve me NJVQV-të për politikën, legjislacionin dhe normat që ndikojnë drejtpërdrejtë në realizimin e funksioneve të NJVQV-ve.**

**Do të realizohet nëpërmjet:**

-inkurajimit të NJVQV-të për të qenë të përgjegjshme ndaj qytetarëve në ofrimin e shërbimeve dhe transparente në menaxhimin e burimeve të tyre financiare. Gjithashtu politikën dhe strategjitë e ndjekura nga Institucionet Rajonale të synojnë harmonizimin me normat e ndjekura

nga NJVQV-të dhe anasjelltas për të arritur qëllimet e përbashkëta me qëllimin final shërbimi ndaj qytetarit.

**8. Konsolidimi i performancës së strukturave të M.C. Konsolidimi i performancës së Drejtorive/ Sektorëve të Menaxhimit të Emergjencave Civile (MC) në Qark, nëpërmjet një veprimtarie të përbashkët në drejtim të parandalimit, planëzimit dhe Menaxhimit të tyre.**

**Realizimit të këtij objekti do ti shërbejë:**

- Rritjes së efikasitetit dhe rolit të Sektorit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në raport me Drejtoritë/Sektorët e EC të NJVQV.
- Organizimi i veprimtarive të ndryshme përgjatë vitit për të ndikuar në mënyrë reciproke në rritjen dhe konsolidimin e performancës së tyre, në parandalimin, përballimin dhe zvogëlimin e dëmeve në rast të ndodhjes së emergjencave civile.

**9. Planëzimi i emergjencave**

- **Hartimi i Planit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në shkallë qarku, bazuar në ndryshimet ligjore e udhëzimet e ardhura nga AKMC, duke i kushtuar rëndësi të veçantë analizës së riskut, llogaritjes së forcave dhe mjeteve (të strukturave vendore, strukturave qendrore dhe të të tretëve) dhe skenarëve të ndryshëm sipas probabilitetit të ndodhjes.**

**Realizimit të këtij objekti do t'i shërbejë:**

- Hartimi i një grafiku të veprimtarive të integruara ndërmjet strukturave të emergjencave civile në nivel qarku.
- Mbështetja në planin e menaxhimit të emergjencave civile në qark, hartuar nga ana e Institucionit të Prefektit , bazuar në legjislacionin në fuqi , përvojës së fituar në vite dhe analizës së riskut sipas çdo bashkie dhe në nivel qarku.
- Hartimi dhe rifreskimi i dokumenteve standarde të marrjes së situatës, vlerësimit të saj, dhënies së udhëzimeve paraprake për çdo aktor (vendor, qendror apo aktorëve të tretë), vendimmarrjes, zbatimit të masave sipas situatës, përgatitjes së raporteve pjesore dhe përfundimtare, kërkesës për mbështetje nga AKMC, kërkesës për mbështetje drejtuar Drejtorisë së Rezervave të shtetit, etj.

**10. Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete në fushën e mbrojtjes civile.**

Realizimi i këtij objekti, në bashkëpunim edhe me strukturat vendore të mbrojtjes civile do ti shërbejë:

- Ndërgjegjësimin të qytetarëve në raport me emergjencat civile.
- Promovimin dhe konsolidimin të veprimtarisë së strukturave të mbrojtjes civile.

## PËRMBAJTJA

I. Raportim dhe informim në ushtrim të funksionit të Prefektit të qarkut.....	3
II. Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore.....	9
1. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore që janë depozituar në zyrën e protokollit të institucionit të Prefektit.....	9
2. Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.....	12
3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të besueshmërisë ligjore të akteve.....	12
III. Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me degët territoriale dhe institucionet shtetërore në nivel vendor.....	17
1. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.....	17
2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier.....	19
3. Drejtoria Vendore e Policisë Fier.....	19
4. Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit.....	21
5. Drejtoria e Doganës Fier.....	22
6. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.....	23
7. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Fier.....	24
8. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Fier.....	25
9. Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.....	29
10. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Fier.....	32
11. Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Rajonit Jugor.....	32

12. OSHEE Drejtoria Rajonale Fier .....	34
13. Drejtoria Rajonale E Arsimit Parauniversitar, Fier.....	35
14. Agjencia Rajonale E Ekstensionit Bujqësor Lushnjë.....	37
15. Sektori i bordit të kullimit.....	40
16. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....	42
17. Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier.....	44
18. Njësitë Vendore Të Kujdesit Shëndetësor.....	45
19. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.....	49
20. Drejtoria Rajonale E Shërbimit Social Shtetëror .....	52
21. Administrata Rajonale E Zonave Të Mbrojtura’ .....	54
22. Agjencia Rajonale E Mjedisit, Fier.....	55
V. Mbrojtja Civile në qark.....	61
VI. Task Forcat, Komitetet Rajonale si dhe Organi Këshillues pranë Prefektit të qarkut.....	66
VII. Rekomandime.....	79
VIII. Objektivat për vitin 2020.....	80
Përmbajtja.....	83